# VLERËSIMI I NEVOJAVE LIGJORE NË SHQIPËRI

TLAS dhe ELSA Albania prezantojnë me kënaqësi punën e tyre në kuadër të "Vlerësimit të Nevojave Ligjore në Shqipëri" të zbatuar si pjesë e planit të veprimit të Koalicionit "Drejtësi për të gjithë."

## Falenderime

*Në emër të TLAS, do doja të falenderoja në rradhë të parë Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), e cila na besoi këtë projekt dhe në të njëjtën kohë na ofroi mbështetje të jashtëzakonshme, pa të cilën ky raport nuk do të ishte i mundur.*

*Së dyti, dua ti jap hapësirë vlerësimit tonë për Zv. Ministrin e Drejtësisë, Z. Toni Gogu, Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Znj. Ogerta Manastirliu, Zv. Kryetaren e Parlamentit, Znj. Vasilika Hysi, Sekretaren e Komisionit të Ligjeve, të Drejtave të Njeriut dhe Administrimit Publik në Parlament, Znj. Klotilda Ferhati, Drejtorin e Përgjithshëm të Gjendjes Civile, Z. Bledar Doracaj, Drejtoreshën e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Znj. Ina Verzivolli, Drejtoreshën e Shërbimit Social, Znj. Etleva Bisha, dhe Zv. Drejtoreshën e Shërbimit Social, Znj. Lida Leskaj. Të gjithë këta persona në postet më të larta drejtuese na kanë ofruar informacion, eksperiencë, dhe pikëpamje të çmuara për zhvillimin e këtij projekti.*

*Së treti, nuk mund të mos përmend të gjithë qytetarët që shpenzuan shumë nga koha e tyre duke u bërë pjesë e fokus grupeve dhe duke iu përgjigjur anketave tona të cilat na ofruan pika të vlefshme për përmirësime të mëtejshme. Së fundmi, por jo më me pak rëndësi, dua të përmend ekspertët dhe vullnetarët e TLAS dhe ELSA për këmbënguljen dhe dedikimin e tyre që mundësuan zhvillimin e këtij raporti të cilësisë së lartë.*

*Ju Faleminderit!*

*Raimonda Bozo*

*Drejtoreshë Ekzekutive, TLAS.*

# Tabela e Përmbajtjes

Falenderime ........ 2
Tabela e Përmbajtjes ........ 3
Lista e Tabelave ........ 5
Lista e Figurave ........ 5
Lista e Fotove ........ 6
Parafjalë ........ 7
1. Objektivi ........ 8
  1.1 Gjetjet Kryesore ........ 8
2. Struktura e Raportit ........ 10
3. Metodologjia ........ 10
  3.1 Kampionimi ........ 10
    3.1.1 Telefonatat ........ 11
    3.1.2 Pyetësorët ........ 14
  3.2 Periudha e Referimit ........ 16
  3.3 Klasifikimi i Problemeve Ligjore ........ 17
  3.4 Analiza e të Dhënave ........ 18
    3.4.1 Analiza Multivariabël ........ 19
    3.4.2 Intervistat dhe Fokus Grupet ........ 21
  3.5 Zgjedhja e Variablave të Pavarura ........ 22
4. Përhapja e Problemeve Ligjore ........ 23
  4.1 Telefonatat ........ 23
    4.1.1 Klasifikimi i Problemeve Ligjore ........ 25
    4.1.2 Faktorët që Influencojnë Përhapjen e Problemeve Ligjore ........ 27
    4.1.3 Faktorët që Influencojnë Llojin e Problemit Ligjor të Hasur ........ 29
  4.2 Pyetësorët ........ 32
    4.2.1 Klasifikimi i Problemeve Ligjore ........ 33
    4.2.2 Faktorët që Influencojnë Llojin e Problemit Ligjor të Hasur ........ 34
5. Pasojat Negative të Problemeve Ligjore ........ 38
  5.1 Telefonatat ........ 38
  5.2 Pyetësorët ........ 40

6. Strategjitë e Përdorura për Problemet Ligjore ........ 41
6.1 Telefonatat ........ 41
6.1.1 Faktorët Demografikë dhe Socioekonomikë që Influencojnë Përgjigjjet ndaj Problemeve Ligjore ........ 43
6.1.2 Faktorët Logjistikë që Influencojnë Përgjigjet ndaj Problemeve Ligjore ........ 45
6.2 Pyetësorët ........ 47
6.2.1 Faktorët Demografikë dhe Socioekonomikë që Influencojnë Përgjigjjet ndaj Problemeve Ligjore ........ 49
6.2.2 Faktorët Logjistikë që Influencojnë Përgjigjet ndaj Problemeve Ligjore ........ 51
7. Finalizimi i Problemeve Ligjore ........ 52
7.1 Telefonatat ........ 52
7.1.1 Faktorët që Influencojnë Zgjidhjen e Problemeve Ligjore ........ 54
7.2 Pyetësorët ........ 56
7.2.1 Faktorët që Influencojnë Zgjidhjen e Problemeve Ligjore ........ 57
8. Konkluzione: Një Qasje Tërësore ndaj Aksesit në Drejtësi ........ 59
Aneksi 1 ........ 62
Kampioni i Plotë nga Telefonatat ........ 62
Kampioni i Plotë nga Pyetësorët ........ 67
Aneksi 2 ........ 72
Struktura e Telefonatave ........ 72
Struktura e Pyetësorëve ........ 74
Aneksi 3 ........ 77
Intervista ........ 77
Fokus Grupet ........ 84
Referenca ........ 89

# Lista e Tabelave

Tabela 1: Shpërndarja e frekuencës kumulative për përhapjen e problemeve ligjore (Telefonatat)........... 24
Tabela 2: Problemet ligjore sipas grupit (Telefonatat) .......... 27
Tabela 3: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore (Telefonatat) .............. 28
Tabela 4: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore lidhur me të drejtat (Telefonatat).......... 29
Tabela 5: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore lidhur me familjen (Telefonatat).......... 31
Tabela 6: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore lidhur me punësimin (Telefonatat).......... 31
Tabela 7: Shpërndarja e frekuencës kumulative për përhapjen e problemeve ligjore (Pyetësorët) ............ 33
Tabela 8: Problemet ligjore sipas grupit (Pyetësorët).......... 33
Tabela 9: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore lidhur me krimet (Pyetësorët) .......... 34
Tabela 10: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore lidhur me familjen (Pyetësorët) .......... 35
Tabela 11: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore lidhur me pronën (Pyetësorët) .......... 36
Tabela 12: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore lidhur me paratë (Pyetësorët) .......... 36
Tabela 13: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore lidhur me punësimin (Pyetësorët) .......... 37
Tabela 14: Lloji i përgjigjes ndaj problemeve ligjore (Telefonatat) .......... 42
Tabela 15: Përmbledhje e regresionit përsa i përket përgjigjjeve ndaj problemeve ligjore (Telefonatat) .. 44
Tabela 16: Lloji i përgjigjes ndaj problemeve ligjore (Pyetësorët).......... 48
Tabela 17: Përmbledhje e regresionit përsa i përket përgjigjjeve ndaj problemeve ligjore (Pyetësorët).... 50
Tabela 18: Përmbledhje e regresionit përsa i përket finalizimit të problemeve ligjore (Telefonatat)......... 55
Tabela 19: Përmbledhje e regresionit përsa i përket finalizimit të problemeve ligjore (Pyetësorët) .......... 58

# Lista e Figurave

Figura 1: Mostra e përftuar nga telefonatat sipas grupmoshave dhe gjinisë .......... 13
Figura 2: Mostra e përftuar nga telefonatat sipas statusit të punësimit dhe edukimit .......... 13
Figura 3: Mostra e përftuar nga telefonatat sipas etnisë dhe statusit të paaftësisë .......... 14
Figura 4: Mostra e përftuar nga pyetësorët sipas grupmoshave dhe gjinisë .......... 15
Figura 5: Mostra e përftuar nga pyetësorët sipas statusit të punësimit dhe edukimit .......... 16
Figura 6: Mostra e përftuar nga pyetësorët sipas etnisë dhe statusit të paaftësisë .......... 16
Figura 7: Përhapja e problemeve ligjore (Telefonatat) .......... 24

Figura 8: Efekte negative shkaktuar nga Problemet Ligjore (Telefonatat) ... 38
Figura 9: Pasojat negative të problemeve ligjore sipas grupit të problemit (Telefonatat) ... 39
Figura 10: Efekte negative shkaktuar nga Problemet Ligjore (Pyetësorët) ... 40
Figura 11: Pasojat negative të problemeve ligjore sipas grupit të problemit (Pyetësorët) ... 41
Figura 12: Përgjigjjet ndaj problemeve ligjore sipas grupit të problemeve (Telefonatat) ... 43
Figura 13: Arsyet për të mos kërkuar ndihmë ligjore (Telefonatat) ... 46
Figura 14: Informacion mbi institucionet që ofrojnë ndihmë ligjore falas (Telefonatat) ... 47
Figura 15: Përgjigjjet ndaj problemeve ligjore sipas grupit të problemeve (Pyetësorët) ... 49
Figura 16: Arsyet për të mos kërkuar ndihmë ligjore (Pyetësorët) ... 51
Figura 17: Informacion mbi institucionet që ofrojnë ndihmë ligjore falas (Pyetësorët) ... 52
Figura 18: Zgjidhja e problemeve ligjore (Telefonatat) ... 53
Figura 19: Zgjidhja e problemeve ligjore sipas grupit të problemeve (Telefonatat) ... 54
Figura 20: Zgjidhja e problemeve ligjore (Pyetësorët) ... 56
Figura 21: Zgjidhja e problemeve ligjore sipas grupit të problemeve (Pyetësorët) ... 57

# Lista e Fotove

Foto 1: Fier, 13 tetor 2017 ... 84
Foto 2: Rrëshen, 18 tetor 2017 ... 85
Foto 3: Laç, 12 janar 2018 ... 86
Foto 4: Shkodër, 12 janar 2018 ... 87
Foto 5: Elbasan, 16 janar 2018 ... 88

# Parafjalë

Ky raport u përgatit dhe u publikua nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), në bashkëpunim me Rrjetin e Studentëve të Drejtësisë në Europë (ELSA) me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), si një nga kornizat e para teorike për vlerësimin e nevojave ligjore në Shqipëri. Që nga viti 1999, TLAS është përpjekur të mbështesë barazinë dhe paanshmërinë në sistemin e drejtësisë dhe të përmirësojë aksesin në drejtësi, sidomos për njerëzit me vështirësi sociale dhe ekonomike. Ky anketim mund të përdoret nga kërkuesit shkencorë, vendimmarrësit politikë, komuniteti i profesionistëve të lidhur me ligjin dhe nga individë të tjerë të interesuar për vlerësimin e nevojave ligjore dhe aksesin në drejtësi.

Vlerësimi i nevojave ligjore mund të shikohet si një mjet i vlefshëm për të mbështetur paanshmërinë dhe barazinë në sistemin e drejtësisë dhe për të përmirësuar aksesin në drejtësi për personat më vulnerabël. Kjo anketë merr një rëndësi të veçantë në kuadër të reformës së re në drejtësi, e cila ndërmjet të tjerave, përpiqet të rregullojë situatën e pabarazisë dhe padrejtësisë që ka mbuluar vendin tonë të paktën në tri dekadat e fundit. Ky studim analizon përhapjen dhe natyrën e problemeve ligjore, rrugët e ndërmarra për zgjidhjen e tyre dhe grupet demografike që vuajnë më së shumti peshën e çështjeve ligjore. Qëllimi përfundimtar është të ofrojmë të dhëna të mbështetura në statistika të vlefshme për të informuar dhe përcaktuar drejtimin për politikat e ofrimit të ndihmës juridike dhe aksesit në drejtësi në Shqipëri.

Për shkak të mungesës së informacionit, hasëm vështirësi të ndryshme për realizimin e projektit, i cili përdor metoda të larmishme kualitative dhe kuantitative. Të vetmet të dhëna të gjendshme për krahasim vijnë nga Instituti i Statistikave së Shqipërisë (INSTAT), arkivat e gjykatave të rretheve dhe arkiva e TLAS. Gjetjet tona përputhen përafërsisht me të dhënat ekzistuese, por i shtojnë mbulim dhe thellësi vlerësimit të nevojave ligjore.

# 1. Objektivi

Ofrimi i shërbimeve ligjore në cilindo territor kërkon si fillim një pikturë të përgjithshme të problemeve ligjore me të cilat njerëzit ndeshen dhe strategjitë që ata përdorin. Në këtë drejtim, kjo është një nga anketimet e para që përpiqet t'i përgjigjet pyetjeve kryesore që lidhen me kuptimin e nevojave ligjore në Shqipëri duke vlerësuar problemet ligjore, natyrën e tyre dhe përgjigjet përkatëse të popullsisë. Nëpërmjet telefonatave dhe pyetësorëve, ky raport analizon:

1. përhapjen e problemeve ligjore ndër njerëzit me probleme ekonomike.
2. natyrën e problemeve ligjore ndër njerëzit me probleme ekonomike dhe njerëzit që kanë hasur të paktën një problem ligjor në 12 muajt e fundit.
3. strategjitë e përdorura nga të dy këto grupe në përgjigje të këtyre çështjeve.
4. llojin e ndihmës juridike së kërkuar për problemin/et dhe arsyet e kësaj zgjedhje.
5. përfundimin e problemit/eve ligjor/e.
6. pasojat e këtij problemi apo këtyre problemeve në jetën e përditshme.
7. influencën që faktorë të ndryshëm demografikë apo socioekonomikë, si mosha, gjinia, statusi i punësimit, etj., kanë në pikat e mësipërme.

## 1.1 Gjetjet Kryesore

Megjithëse do t'i prezantojmë me detaje gjetjet në kapitujt në vazhdim, disa nga zbulimet më të rëndësishme të këtij studimi janë:

1. Njerëzit me probleme ekonomike janë veçanërisht vulnerabël ndaj problemeve ligjore. Pothuaj 70% e subjekteve të kampionit tonë kanë deklaruar që janë përballur me të paktën një problem ligjor gjatë vitit të fundit.
2. Njerëzit me probleme ekonomike vuajnë veçanërisht nga probleme ligjore të lidhura me të drejtat (përfshirë këtu probleme me regjistrimin në gjendjen civile, ndihmën ekonomike, apo banesat sociale), familjen (përfshirë këtu çështje divorci apo përgjegjësie prindërore) dhe punësimin. Këto tri fusha mbulojnë më shumë se 70% të gjithë problemeve të identifikuara nëpërmjet bisedave telefonike.

3. Në mes njerëzve në vështirësi ekonomike, grupet më vulnerabël ndaj problemeve ligjore janë indivitët me aftësi të kufizuar dhe komuniteti Roma.
4. Në mes njerëzve që kanë ndeshur të paktën një problem ligjor përgjatë vitit të kaluar, çështjet më të përhapura janë ato që lidhen me krime apo familjen, kurse më të rrallat lidhen me të drejtat, shkaktimin e dëmit dhe banimin.
5. 95% e njerëzve me vështirësi ekonomike që janë përballur me një problem ligjor vitin e kaluar vlerësojnë që ky problem ka pasur pasoja negative në jetën e tyre të përditshme. Nga këta, pothuaj çereku i ka vlerësuar këto pasoja si të rënda.
6. Sipas pyetësorit, 85% e njerëzve që kanë ndeshur një problem vitin e kaluar kanë përjetuar ndërlikime si pasojë dhe 22% e tyre janë klasifikuar si të rënda.
7. Nga njerëzit me vështirësi ekonomike, vetëm 26% e subjekteve kanë kërkuar ndihmë ligjore për problemin ose problemet e tyre. Të tjerët ose janë mbështetur në strategji të ndërtuara vetë (26%) ose nuk kanë bërë asgjë në përgjigje të problemit të tyre (48%).
8. Përsa i përket pikës 7), grupet që priren të mos kërkojnë ndihmë ligjore janë komuniteti Roma, personat që s'kanë mbaruar gjimnazin, të papunët dhe njerëz që nuk banojnë në Tiranë.
9. Përsa i përket pikës 7), mungesa e burimeve financiare shpjegon 61% të rasteve për të cilat ndihma juridike nuk është kërkuar. Nga ana tjetër 30% e subjekteve në fjalë nuk e kërkojnë ndihmën ligjore për shkak të mungesës së besimit në institucionet përkatëse (duke përfshirë avokatët privatë, avokatët kryesisht dhe OJQ-të që ofrojnë ndihmë ligjore falas).
10. Përsa i përket pikës 9), më shumë se 63% e individëve qe nuk kërkojnë ndihmë ligjore për shkak të mungesës së burimeve financiare nuk janë në dijeni (ose kanë njohuri të limituara për proçesin) të mundësive për të përfituar ndihmë juridike falas nga shteti ose OJQ përkatëse.
11. Përqindjet e referuara në pikën 7) janë shumë të ndryshme për kampionin tjetër. Personat që kanë ndeshur të paktën një problem ligjor vitin e kaluar nuk kanë kërkuar ndihmë të jashtme për "vetëm" 42% të rasteve.
12. Përsa i përket pikës 11), grupet që më së shumti nuk kërkojnë asistencë ligjore janë komuniteti Roma, individë me të ardhura familjare nën mesataren e të ardhurave për frymë në Shqipëri dhe individë me aftësi të kufizuara.

13. Përsa i përket pikës 11), mungesa e burimeve financiare shpjegon 53% të rasteve për të cilat ndihma juridike nuk është kërkuar. Nga ky numër, përafërsisht 34% e të anketuarëve nuk kanë pasur dijeni (ose kanë pasur informacion të limituar) për mundësitë për të përfituar ndihmë juridike falas nga shteti ose OJQ-të përkatëse.
14. Nga kampionimi i njerëzve me vështirësi ekonomike rezulton se treçereku i tyre nuk kanë qenë në gjendje të zgjidhin asnjë nga problemet ligjore të ndeshura në 12 muajt e fundit.
15. Nga njerëzit me vështirësi ekonomike, grupet më me shumë mundësi për të mos zgjidhur problemet e tyre ligjore janë njerëzit që nuk kërkojnë ndihmë juridike, individët që nuk kanë përfunduar gjimnazin dhe komuniteti Roma.

# 2. Struktura e Raportit

Ky studim është ndërtuar në mënyrën që shpjegohet më poshtë. Kapitulli tjetër shpjegon metodologjinë, duke përfshirë mënyrat e mbledhjes dhe analazimit të të dhënave. Kapitulli 4 prezanton një përmbledhje mbi përhapjen e problemeve ligjore, natyrën e tyre dhe faktorët që i influencojnë. Kapitulli 5 analizon pasojat negative që këto probleme kanë shkaktuar në jetët e të të anketuarve. Më tutje, studimi shqyrton strategjitë e përdorura nga subjektet e këtyre kampioneve për të përballuar këto shqetësime ligjore. Kapitulli i shtatë vlerëson finalizimin e këtyre problemeve dhe faktorët që ndikojnë këto përfundime. Kapitulli 8 përmbyll duke ofruar një afrim gjithëpërfshirës për nxitjen e barazisë dhe paanshmërisë në sistemin e drejtësisë.

# 3. Metodologjia

Ky studim përfshin përafërsisht 1000 (1007) telefonata dhe 1000 (1002) pyetësorë, të cilat u administruan përgjatë periudhës tetor-dhjetor 2018.

## 3.1 Kampionimi

### 3.1.1 Telefonatat

Të 1007 të intervistuarit u zgjodhën nëpërmjet një proçesi kampionimi “ortek bore.” Ky lloj kampionimi i referohet një teknike të zgjedhjes së mostrës në mënyrë jo të rastësishme ku subjektet e tjerë identifikohen me ndihmën e një grupi të vogël fillestar. Me fjalë të tjera, studiuesi pyet subjektet e tij të parë për informacion rreth të njohurve të tij apo saj të cilët mund t’i shtohen mostrës. Këto të fundit gjithashtu pyeten rreth të njohurve të tyre dhe ky proçes zinxhir vazhdon dhe i ngjan gjithmonë e më shumë një orteku bore.

Grupi ynë fillestar përbëhej nga klientë të TLAS, të cilët duke parë që nuk janë në gjendje të paguajnë për ndihmën ligjore që i nevojitet klasifikohen automatikisht si individë me vështirësi ekonomike. Ne i pyetëm ata për numrat e telefonit të tre të njohurve të tyre, të cilët ata mund t’i klasifikonin në mënyrë intuitive si me probleme ekonomike. Këta të fundit u kontaktuan the u pyetën nëse mund të përballonin ekonomikisht një problem ligjor (nëse do të kishin një) dhe në rast të një përgjigje negative u klasifikuan si individë me vështirësi ekonomike. Ky proçes u përsërit derisa arritëm të plotësonim një mostër pune prej afro 1000 të intervistuarish. Kontaktimi i çdo subjekti të ri në të njëjtën mënyrë njihet statistikisht si kampionim “ortek bore” eksponencial jo-diskriminues.

Kjo metodë e zgjedhjes së mostrës lejon vlerësimin e problemeve dhe nevojave ligjore të një prej grupeve më vulnerabël në shoqëri (Currie, 2005; Dale, 2009; Legal Services Corporation, 2017). Sidoqoftë, kjo metodë kampionimi ka kufizime të caktuara. Pikë së pari, ajo është nga natyra jo përfaqësuese e popullsisë së përgjithshme duke qenë se pasqyron popullsinë e njerëzve me vështirësi ekonomike. Së dyti, subjektet janë vetëzgjedhur — ne i besojmë gjykimit të tyre për aftësinë financiare për të përballuar një proçes gjyqësor— dhe janë jashtë kontrollit të studiuesit. Me fjalë të thjeshta autorët e këtij studimi kanë marrë për bazë vlerësimin e të intervistuarve rreth statusit të tyre ekonomik.

Arsyet për këtë zgjedhje janë të trefishta. Ashtu siç u tha më lart, ky lloj kampionimi mundëson vlerësimin e parë të nevojave ligjore të personave me vështirësi ekonomike në Shqipëri.[1] Së dyti, të dhënat e INSTAT-it nuk janë të mjaftueshme për të saktësuar një kampion

---

[1] Përsa i përket lejimit të vetëzgjedhjes së subjekteve, vendimi u mor në bazë të arsyetimeve logjistike. Për të pasur një mostër të kontrolluar të individëve me vështirësi ekonomike do të na duhej të merrnim të dhëna nga zyrat e punës. Sidoqoftë, kjo metodë mund të krijonte kampione jo të përshtatshme duke parë që njerëz të varfër shpesh nuk regjistrohen dhe ata që regjistrohen shpesh nuk mund të klasifikohen si të varfër. Për shembull, nga eskperienca e TLAS, ne dimë se një numër i madh i komunitetit Roma nuk regjistrohen në këto zyra.

rastësor përsa i përket faktorëve kyç demografikë dhe socioekonomikë. INSTAT ofron informacion mbi këto aspekte në mënyrë të veçantë por jo të kombinuar, psh., ne mund të dimë numrin e personave të gjinisë femërore apo të papunëve në Republikën e Shqipërisë, por nuk kemi informacion mbi numrin e femrave të papuna me shkollim të lartë.

Së treti, një kampionim i rastësishëm përfaqësues i gjithë popullsisë nuk ishte i mundur për arsye logjistike. Kompanitë e telefonive celulare në Shqipëri nuk japin informacion mbi numrat e klientëve të tyre, ndaj e vetmja mënyrë për të realizuar thirrje të rastësishme ishte me anë të telefonave fiks. Në këtë drejtim, provuam një studim pilot në shtator 2018, i cili dështoi të prodhonte një rezultat të kënaqshëm. Numëratori telefonik nuk është përditësuar në vitet e fundit dhe përqindja e përgjigjeve ishte poshtë 40%. Numri i ulët i përgjigjeve mund të krijojë kampione jo përfaqësuese (Smith 2009). Në rastin tonë, rreziku ishte ai i prodhimit të një mostre që nënvlerësonte numrin e njerëzve me vështirësi ekonomike. Duke qenë se numëratori nuk ishte përditësuar, të anketuarit do duhet të ishin residentë në një shtëpi për më shumë se 1 vit, e cila nënkupton një lloj stabiliteti ekonomik. Për më tepër, duke qenë se telefonat fiks janë të lidhur me një adresë dhe identitet specifik, subjektet u shfaqën hezitues për të dhënë informacion sensitiv, sidomos të lidhur me të ardhurat dhe pasurinë e tyre.[2] Në fakt, asnjë nga të pyeturit e këtij studimi pilot nuk pranoi të kishte hasur probleme ligjore përgjatë 12 muajve të fundit.

Duke u nisur nga këto vështirësi, ne vlerësuam kampionimin "ortek bore" eksponencial jo-diskriminues si strategjinë më të mirë të mundshme. Sidoqoftë, është e rëndësishme të kuptojmë limitimet e këtij lloj kampionimi gjatë analizës të të dhënave. Ne plotësuam 1007 telefonata të suksesshme me një përqindje përgjigjesh prej 92% (nga 1095 telefonata totale). Karakteristikat e mostrës së prodhuar nga telefonatat dhe struktura e telefonatave mund të gjenden përkatësisht në Anekset 1 dhe 2. Grafikët e mëposhtëm japin një pamje të përgjithshme të kësaj mostre.

[2] Ndërkohë që përqindja e ulët e përgjigjeve nuk lejon për kampionim rastësor të thjeshtë, mungesa e të dhënave të plota nga INSTAT dhe hezitimi i të anketuarve për të ofruar informacion sensitiv nuk lejon formimin e mostrave të stratifikuara. Si përfundim, kampionimi rastësor ishte i pamundur.

*Figura 1: Mostra e përftuar nga telefonatat sipas grupmoshave dhe gjinisë*







*Figura 2: Mostra e përftuar nga telefonatat sipas statusit të punësimit dhe edukimit*






*Figura 3: Mostra e përftuar nga telefonatat sipas etnisë dhe statusit të paaftësisë*







### 3.1.2 Pyetësorët

1002 pyetësorë u shpërndanë në gjykatat kryesore të rretheve, Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, sipas madhësisë së qarqeve (sipas të dhënave të INSTAT).[3] Ky është një shembull i kampionimit të përshtatshëm, i cili është veçanërisht i dobishëm për studime pilot — pavarësisht se ne jemi të bindur që studimi ynë përfaqëson një vlerësim të plotë të nevojave dhe problemeve ligjore në Shqipëri, ai mbetet një nga orvatjet e para serioze në këtë fushë dhe përpjekje të mëtejshme do të jenë të nevojshme në të ardhmen.

Duke parë që pyetësorët u shpërndanë nëpër gjykatat e rretheve, është e qartë që një shumicë dërrmuese e subjekteve do të ishin përballur me probleme ligjore kohët e fundit. Prandaj, duke qenë të vetëdijshëm se kampioni mund të ishtë tepër i anshëm përsa i përket pyetjes mbi përhapjen e problemeve ligjore, ne vendosëm që t'a hiqnim këtë të fundit si variabël përgjigje — seksioni 3.4.1 shpjegon më me detaje se ç'janë këto lloj variablash. Në fakt, pyetja e 11 e pyetësorit (kontrollo Aneksin 2) eleminon nga mostra ato subjekte që nuk kanë ndeshur të paktën një problem ligjor në 12 muajt e fundit.

Për të shmangur grumbullimet në kampionim (psh. të pyesësh njerëz të së njëjtës familje që ndeshen me të njëjtin problem ligjor), ne përdorëm një përshtatje të kampionimit sistematik.

[3] Berat 53 subjekte, Durrës 115, Elbasan 115, Fier 122, Korçë 87, Shkodër 84, Tiranë 349, Vlorë 77.

“Kampionimi sistematik është një tip i kampionimit të rastësishëm në të cilin subjektet nga një popullsi më e madhe zgjidhen sipas një pikë fillestare të rastësishme dhe një intervali fiks. Ky interval, i quajtur intervali i kampionimit, llogaritet duke pjesëtuar madhësinë e popullsisë me madhësinë e dëshiruar të mostrës. Kampionimi sistematik mendohet të jetë i rastësishëm nëse intervali përcaktohet më parë dhe pika e fillimit është e rastësishme”(Gravetter and Wallnau, 2012, p.39). Në rastin tonë, sidoqoftë, ne nuk mund të përcaktonim paraprakisht madhësinë e popullsisë, dmth., individët që janë ndeshur me të paktën një problem ligjor në 12 muajt e fundit, ndaj zgjodhëm arbitrarisht një interval kampionimi të barabartë me 4. Ky interval kampionimi nënkupton që një në katër individë që futen në gjykatën përkatëse i kërkohet të plotësojë pyetësorin.

Karakteristikat e mostrës së prodhuar nga pyetësorët dhe struktura e pyetësorëve mund të gjenden përkatësisht në Anekset 1 dhe 2. Grafikët e mëposhtëm japin një pamje të përgjithshme të kësaj mostre.

*Figura 4: Mostra e përftuar nga pyetësorët sipas grupmoshave dhe gjinisë*






*Figura 5: Mostra e përftuar nga pyetësorët sipas statusit të punësimit dhe edukimit*







*Figura 6: Mostra e përftuar nga pyetësorët sipas etnisë dhe statusit të paaftësisë*







### 3.2 Periudha e Referimit

Periudha e referimit nënkupton kohën e marrë në konsideratë për anketën, dmth., sa i vjetër mund të jetë një problem ligjor për t'u përfshirë në anketë. Ne kemi zgjedhur një periudhë referimi të barabartë me një vit, për të shmangur, në njërën anë nënvlerësimin e problemeve ligjore, për shkak të harresave (të cilat janë më të shpeshta për periudha më të gjata referimi), dhe, në tjetrën, matjen e problemeve të reja në vend të ekzistencës së problemeve ligjore (për

periudha më të shkurtra referimi). Në këtë aspekt, studimi ynë ndjek metodën e përdorur nga Coumarelos and Ramsey (2012).

### 3.3 Klasifikimi i Problemeve Ligjore

Telefonatat dhe pyetësorët lejojnë subjektet të përshkruajnë problemin (apo problemet) e hasur ligjor me fjalët e tyre. Kjo zgjedhje bëhet për të shmangur nën-raportimin e problemeve duke qenë se disa individë mund të mos kenë mjaftueshëm informacion për të klasifikuar në mënyrë të saktë problemin apo problemet që ndeshin (nëse ne do t'i ofronim një grup të limituar alternativash rreth natyrës së problemit). Sidoqoftë, për motive statistikore — mbledhje dhe përpunim i të dhënave — ne i kemi klasifikuar çështjet përkatëse në tetë grupe:

1. Krime (Vepra penale)
    a. Të akuzuar
        i. Dhuna në Familje
        ii. Ndërtim i Paligjshëm
        iii. Vjedhje
        iv. Tjetër
    b. Viktima
        i. Dhuna në Familje
        ii. Vjedhje
        iii. Tjetër
2. Punësimi
    a. Zgjidhje e Kontratës së Punës
    b. Kushtet e Punës
    c. Tjetër
3. Familja

    a. Kujdestari e Fëmijës
    b. Divorci
    c. Përgjegjësia Prindërore
    d. Tjetër
4. Banimi
    a. Qira
    b. Tjetër
5. Para
    a. Falimentimi
    b. Hua
    c. Trashëgimi
    d. Tjetër
6. Shkaktim Dëmi
7. Prona
8. Të drejta
    a. Regjistrim Civil
    b. Ndihmë Ekonomike
    c. Tjetër

### 3.4 Analiza e të Dhënave

Të dhënat e mbledhura nga anketa u përpunuan duke përdorur metoda të statistikës përshkruese dhe inferenciale. Statistika përshkruese i referohet prezantimit të të dhënave të mbledhura në një mënyrë të qartë dhe të organizuar, psh., grafikët në seksionet 3.1.1 dhe 3.1.2 Në anën tjetër, statistika inferenciale përfshin të gjithë ato metoda që përdorin të dhënat e

kampionit për të nxjerrë përfundime mbi parametrat e popullsisë, dmth., sa e mundur është që efektet e gjetura në një mostër të pasqyrojnë realisht ato të popullsisë dhe jo gabime të kampionimit.[4]

Është e nevojshme të rikujtojmë se ky studim nuk analizon popullsinë e Republikës së Shqipërisë duke parë që nuk është e mundur marrja e një mostre të rastësishme të kësaj popullsie. Gjetjet tona janë të rëndësishme për individët të vetë-identifikuar në vështirësi ekonomike dhe ata që janë ndeshur me të paktën një problem ligjor në vitin e fundit. Metoda e statistikës inferenciale e përdorur në këtë raport është një tip i analizës multivariabël (dmth., analizë që përfshin më shumë se një variabël shpjeguese) i cili njihet si regresion binar logjistik.

### 3.4.1 Analiza Multivariabël

Konceptualisht analizat multivariabël vlerësojnë marrëdhënien midis më shumë se dy variablash. Në këtë pikë është e nevojshme të largohemi për pak nga tema e studimit dhe të sqarojmë disa pika kyçe lidhur me variablat e pavarura dhe të varura.

Studiesit shpesh analizojnë sesi një ose më shumë variabla ndikojnë të tjerat. Për shembull, ekonomistët mund të duan të vlerësojnë efektin që një taksë mund të ketë mbi investimet, politologët, efektin e një sistemi elektoral mbi stabilitetin politik, e kështu me rradhë. Variablat që influencojnë, psh., madhësia e taksës apo tipi i sistemit elektoral, njihen si variabla të pavarura, shpjeguese ose ekzogjene. Nga ana tjetër, variablat që influencohen, psh., sasia e investimeve apo stabiliteti politik, referohen si variabla të varura, përgjigje ose endogjene. Duke përdorur metoda të ndryshme statistikore, psh., analizat multivariabël ose bivariabël (me dy variabla), kërkuesi mund të shqyrtojë marrëdhëniet midis këtyre variablave.

Sidoqoftë, këto emërtime vendosen në mënyrë arbitrare dhe përdoren për të qartësuar punën e kërkuesit. Statistika inferenciale mund të vlerësojë vetëm korrelacionin midis variablave, dmth., sa shumë këto variabla lëvizin së bashku përkundrejt sa levizin veçmas. Pyetjes se kush është variabli i varur (pasoja) dhe kush janë të pavarurit (shkaqet) mund t'i përgjigjemi vetëm duke përdorur llogjikën dhe literaturën ekzistuese. Për shembull, një analizë

[4] Gabimet në kampionim nuk janë probleme që mund të shmangen nga kërkuesi. Jo të gjitha mostrat që merren nga një popullsi e caktuar janë të njëjtë, ose dhe të ngjashëm, prandaj gabimi në kampionim reflekton mundësinë e zgjedhjes, në mënyrë të pavullnetshme, të një mostre shumë të rrallë që nuk përfaqëson popullsinë përkatëse.

bivariabël mund të tregojë se një tip sistemi elektoral është shumë i lidhur me stabilitetin politik, por nuk mund të përcaktojë nëse është ky sistem që nxit stabilitetin apo anasjelltas.

Për t'u kthyer mbrapsht në studimin tonë, ne duam të vlerësojmë sesi disa faktorë demografikë dhe socioekonomikë ndikojnë në përhapjen e problemeve ligjore, natyrën e këtyre problemeve, strategjitë e përdorua si përgjigje dhe finalizimin e tyre. Fatmirësisht, në këtë rast, klasifikimi i variablave në të varura dhe të pavarura është i lehtë dhe nuk kërkon informacion shtesë përveç logjikës së përgjithshme, dmth., është e arsyeshme të mendojmë që mosha, gjinia, edukimi ose etnia mund të ndikojë në përhapjen e çështjeve ligjore dhe jo anasjelltas.

Analizat multivariabël mund të marrin forma të ndryshme, duke përfshirë ato lineare, log-lineare, MANOVA, etj. Në princip, ato i përgjigjen së njëjtës pyetje, sa shumë variablat në fjalë lëvizin së bashku dhe jo veçmas. Ndryshimet midis këtyre metodave lidhen me supozimet që ato pranojnë. Për shembull, analiza lineare multivariabël, që ka numrin më të madh të supozimeve, kërkon marrëdhënie lineare midis variablash, shpërndarje normale të mbetjeve, homoskedasticitet dhe mungesë multikolineariteti.[5]

Ky studim përdor regresione binare logjistike për dy arsye. Pikë së pari, ky lloj regresioni nuk kërkon shumë nga supozimet kyçe të regresionit linear, psh., marrëdhënie lineare, shpërndarje normale të mbetjeve apo homoskedasticitet.[6] Gjithsesi, regresioni binar logjistik kërkon që variabli i varur të jetë binar (më shumë mbi këtë pjesë në paragrafet në vazhdim), matjet (dmth. subjektet) të jenë të pavarura nga njëra-tjetra (kjo është përpjekur të arrihet me anë të kampionimit sistematik), mungesë multikolineariteti të theksuar (të cilin e testuam me anë të faktorëve që rrisin variancën) dhe një mostër relativisht të madhe (me më shumë se 100 subjekte apo matje).

Së dyti, zgjedhja e kësaj metode u ndikua nga niveli i matjes së variablave të përdorur. Një variabël mund të ketë katër lloj nivelesh matje: nominal, ordinal, interval, ose raport. Variablat me nivel matës nominal i referohen atyre variablave që mund të marrin vetëm një

---

[5] Nëse dikush është i interesuar për një përmbledhje të shkurtër mbi kuptimin dhe implikimet e këtyre kushteve, mund t'i hedhë një sy shpjegimit elegant të përgatitur nga Osborne and Waters (2002).

[6] Duke qenë se ky është një nga studimet e para (në mos i pari) që mbledh kësilloj të dhënash për këto popullsi (njerëz me vështirësi ekonomike apo ata që kanë hasur të paktën një problem ligjor vitin e fundit në Shqipëri), ne nuk kemi informacion të besueshëm për shpërndarjen e këtyre të dhënave, prandaj të pranuarit si të vërtetë të shumë hipotezave mbi këto popullsi mund të rezultonte e pasaktë.

numër të caktuar vlerash që nuk kanë një sens natyral renditje, psh., ngjyra e flokëve. Në anën tjetër, varibla me nivel matje ordinal mund të marrin vetëm një numër të caktuar vlerash por kanë një sens natyral renditje, psh., niveli i edukimit. Variablat që kanë nivel matje interval ose raport nuk janë të limituara, ose janë shumë pak të limituara, në shtrirjen e vlerave që mund të marrin — prandaj ato shpesh etiketohen si matje të vazhdueshme. I vetmi ndryshim midis këtyre dy kategorive (interval dhe raport) është caktimi i një zero në mënyrë arbitrare për variablat interval, psh., temperatura në Celsisus, dhe ekzistenca e një zero reale për variablat raport, psh., gjatësia.

Ashtu si u tha më lart, regresioni binar logjistik kërkon që variabla e varur të jetë binare. Një variabël binare mund të marrë vetëm dy vlera të mundshme, ndaj mund të jetë vetëm një variabël me nivel matje nominale. Raporti ynë përdor disa nga këto variabla, psh., përhapjen e problemeve ligjore (duke dalluar midis atyre që janë dhe atyre që nuk janë ndeshur me një çështje ligjore vitin e fundit), finalizimin e problemeve ligjore (nëse këto probleme janë zgjidhur apo jo), ndihmën ligjore (nëse është kërkuar ose jo). Një arsye shtesë për të përdorur regresion logjistik dhe jo linear lidhet me natyrën e variablave të pavarura. Regresionet lineare përdorin variabla të vazhdueshme dhe të gjitha variablat tona të pavarura janë diskrete (shikoni në seksionin 3.5 për më shumë detaje).

### 3.4.2 Intervistat dhe Fokus Grupet

Përtej vlerësimit kuantitativ të nevojave ligjore me anë të telefonatave dhe pyetësorëve, ky raport përfshin dhe një analizë kualitative të problemeve ligjore dhe zgjidhjeve të mundshme. Kjo analizë bazohet në pesë intervista me vendimmarrës të nivelit të lartë që janë të lidhur me sistemin e ofrimit të ndihmës juridike dhe pesë fokus grupe me aktorët dhe përfituesit kryesorë të kësaj ndihme. Intervistat u zhvilluan me Zv. Ministrin e Drejtësisë, Z. Toni Gogu, Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Znj. Ogerta Manastirliu, Zv. Kryetaren e Parlamentit, Znj. Vasilika Hysi, Sekretaren e Komisionit të Ligjeve, të Drejtave të Njeriut dhe Administrimit Publik në Parlament, Znj. Klotilda Ferhati dhe Drejtoreshën e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Znj. Ina Verzivolli. Nga ana tjetër, fokus grupet u zhvilluan në Fier, Rrëshen, Laç, Shkodër dhe Elbasan. Detajet e këtyre intervistave dhe fokus grupeve mund të gjenden në Aneksin 3.

## 3.5 Zgjedhja e Variablave të Pavarura

Si variabla të pavarura (shpjeguese), ky studim përdor shtatë indikatorë demografikë dhe socioekonomikë për secilin model, dmth., për individët që kanë hasur të paktën një problem ligjor vitin e fundit dhe për individët në vështirësi ekonomike. Në rastin e parë, ne përdorim moshën, gjininë, statusin e punësimit, nivelin e edukimit, etnicitetin, statusin e paaftësisë dhe nivelin e të ardhurave ekonomike në familje. Këta faktorë u zgjodhën për shkak të rëndësisë së përgjithshme (çdo njeri është i vlerësueshëm në këto indikatorë), por edhe për shkak të literaturës ekzistuese — studime për vende të tjera rreth vlerësimit të nevojave ligjore — sugjerojnë që këto aspekte influencojnë përhapjen dhe natyrën e problemeve ligjore, psh., Australia (Coumarelos and Ramsey, 2012), Bullgaria (Gramatikov, 2008), Kanadaja (Currie, 2005), Kina (Michelson, 2007), Hollanda (van Velthoven, 2004), Irlanda e Veriut (Dignan, 2006) dhe kështu e me rradhë.

Këto variabla të pavarura janë koduar në një mënyrë të caktuar. Variabli "moshë" mund të marrë katër vlera në bazë të grupmoshave 14-24 vjeç, 25-44, 45-64 dhe mbi 65 vjeç.[7] Gjinia është koduar si variabël binar më të vetmet vlera të mundshme, mashkull ose femër — megjithëse ne e kuptojmë që gjinia është një spektër me shumë vlera dhe anketat i lejuan subjekteve të vlerësonin gjininë e tyre në të gjitha mënyrat, mashkull dhe femër ishin të vetme matje të identifikuara. Statusi i punësimit u kodua si një variabël nominal duke dalluar midis të punësuarve, të papunëve, pensionistëve dhe studentëve. Niveli i edukimit u zhvillua natyrshëm si një variabël ordinal me tri kategori, persona pa diplomë gjimnazi, me diplomë gjimnazi por pa shkollë të lartë dhe me shkollë të lartë. Përsa i përket etnisë, subjektet u lejuan të përshkruanin identitetin e tyre kombëtar si ta cilësonin më të përshtatshme. Sidoqoftë, për shkak të përgjigjeve, etniciteti u kthye pothuajse në një variabël me dy kategori, Shqiptar dhe Roma. Në anën tjetër, statusi i paaftësisë dhe të ardhurat familjare u koduan si variabla binarë. Ky studim dallon midis njerëzve me të paktën një paaftësi dhe atyre që janë plotësisht "të shëndetshëm" dhe

[7] Ky variabël është koduar si diskret për të shmangur problemet që lindin kur regresionet binare logjistike operojnë me variabla të vazhdueshme dhe duke parë që të gjitha variablat e tjerë nuk ishin të vazhdueshëm u desh të përshtatnim moshën në këtë mënyrë.

midis individëve me të ardhura familjare nën mesataren (e matur si PBB i Shqipërisë për frymë)[8] dhe të atyre me të ardhura familjare mbi mesataren.[9]

Përsa i përket telefonatave, ne përdorëm të njëjtin set variablash, me ndryshimin e vetëm që zëvendësojmë nivelin e të ardhurave me vendbanimin e subjektit — do të ishte e pakuptimtë të përfshinim nivelin e të ardhurave si faktor shpjegues për një mostër të vetëzgjedhur si individë me vështirësi ekonomike. Vendbanimi i subjekteve i referohet qytetit në të cilin të anketuarit jetonin në kohën e intervistës dhe u kodua si binar, individë që banojnë në Tiranë dhe jashtë Tirane.

# 4. Përhapja e Problemeve Ligjore

## 4.1 Telefonatat

Të anketuarit u pyetën rreth problemeve ligjore që kishin hasur vitin e fundit. Nga 1007 subjekte, 695 (65%) pranuan të ishin ndeshur me të paktën një aksident që, sipas tyre, mund të krijonte ose kishte krijuar një problem ligjor. Në mes të këtij grupi regjistruam 563 individë (81%) me vetëm një problem ligjor, 77 (11.1%) me dy, 36 (5.2%) me tre dhe vetëm 19 (2.7%) persona kishin pasur katër ose më shumë çështje ligjore gjatë 12 muajve të fundit.

[8] (World Bank, 2017)
[9] Kodimi i këtij variabli ndikohet nga të njëjtat konsiderata si për variablin “moshë.”

*Figura 7: Përhapja e problemeve ligjore (Telefonatat)*




*Tabela 1: Shpërndarja e frekuencës kumulative për përhapjen e problemeve ligjore (Telefonatat)*

| Nr. i problemeve për subjekt | Subjekte | | Probleme | |
|---|---|---|---|---|
| | Nr. | Kumulativ % | Nr. | Kumulativ % |
| 0 | 312 | 31 | | |
| 1 | 563 | 86.9 | 563 | 61 |
| 2 | 77 | 94.5 | 154 | 77.7 |
| 3 | 36 | 98.1 | 108 | 89.4 |
| 4 | 7 | 98.8 | 28 | 92.4 |
| 5 | 5 | 99.3 | 25 | 95.1 |
| 6 | 3 | 99.6 | 18 | 97 |
| 7 | 4 | 100 | 28 | 100 |
| Totali | 1007 | | 924 | |

Ashtu si tregon tabela më lart, një numër i vogël subjektesh mbajnë një numër disproporcionalisht më të madh të çështjeve ligjore të hasura. Për shembull, vetëm 5.5% e individëve të kësaj mostre kanë hasur më shumë se 2 probleme vitin e shkuar por eksperiencat e tyre përfshijnë pothuaj çerekun (22.3%) e gjithë grupit.

### 4.1.1 Klasifikimi i Problemeve Ligjore

Ashtu si u tha në kapitullin e tretë, ne lejuam të anketuarit të përshkruanin me fjalët e tyre problemin apo problemet ligjore, të cilët, më pas, u klasifikuan në një nga kategoritë e mëposhtme:

1. Krime (Vepra penale)
    a. Të akuzuar
        i. Dhuna në Familje
        ii. Ndërtim i Paligjshëm
        iii. Vjedhje
        iv. Tjetër
    b. Viktima
        i. Dhuna në Familje
        ii. Vjedhje
        iii. Tjetër
2. Punësimi
    a. Zgjidhje e Kontratës së Punës
    b. Kushtet e Punës
    c. Tjetër
3. Familja

    a. Kujdestari e Fëmijës
    b. Divorci
    c. Përgjegjësia Prindërore
    d. Tjetër
4. Banimi
    a. Qira
    b. Tjetër
5. Para
    a. Falimentimi
    b. Hua
    c. Trashëgimi
    d. Tjetër
6. Shkaktim Dëmi
7. Prona
8. Të drejta
    a. Regjistrim Civil
    b. Ndihmë Ekonomike
    c. Tjetër

Tabela më poshtë tregon kompozimin e 924 çështjeve ligjore sipas llojit të problemit. Kjo pasqyrë tregon sesi një numër shumë i madh rastesh janë të lidhura me çështje të familjes apo të drejtash. Shuma e këtyre dy kategorive përfshin 57.7% të gjithë grupit të rasteve të identifikuara me anë të telefonatave. Në njëfarë mënyre ky rezultat ishte i pritshëm duke qenë se mostra jonë përbëhet nga individë të vetëidentifikuar me vështirësi ekonomike. Duke parë numrin relativisht të madh të komunitetit Roma apo individëve me paaftësi në këtë kampion, çështje si regjistrimi

civil, ndihma ekonomike apo divorci priteshin të ishin shumë të përhapura. Nga ana tjetër, problemet më pak të ndeshura ishin ato të lidhura me paratë dhe banimin. Këto rezultate mund të shpjegohen nga mungesa e mundësive të subjekteve në mostrën tonë për të marrë borxh apo shtëpi me qera.

*Tabela 2: Problemet ligjore sipas grupit (Telefonatat)*

| Grupi | Nr. | % |
|---|---|---|
| Krime | 69 | 7.5 |
| Punësimi | 125 | 13.5 |
| Familja | 211 | 22.8 |
| Banimi | 23 | 2.5 |
| Para | 27 | 2.9 |
| Shkaktim dëmi | 52 | 5.6 |
| Prona | 95 | 10.3 |
| Të drejta | 322 | 34.9 |
| Totali | 924 | 100 |

### 4.1.2 Faktorët që Influencojnë Përhapjen e Problemeve Ligjore

Pasi përshkruam numrin dhe natyrën e problemeve ligjore të idenitifikuara, raporti përqendrohet te faktorët socialë dhe demografikë që ndikojnë shancet e të pasurit një problem ligjor. Për këtë arsye, ne përdorim një regresion binar logjistik lidhur me përhapjen e çështjeve ligjore. Variabli ynë i varur është ndeshja ose jo me të paktën një problem ligjor në 12 muajt e fundit (që mund të marrë vetëm dy vlera, “0” për “Jo” dhe “1” për “Po”), ndërkohë që shtatë indikatorë demografikë dhe socioekonomikë përfaqësojnë variablat e pavarur. Me fjalë të tjera, ky studim kërkon të hulumtojë se cilat kategori janë më të prirura, dhe sa më të prirura, për t’u përballur me probleme ligjore. Tabela e mëposhtme tregon se cilët faktorë janë në mënyrë të pavarur statistikisht domethënës[10] dhe efektet përkatëse në mundësinë e përballjes me probleme ligjore. Variablat e pavarur që konsiderohen në këtë regresion janë mosha, gjinia, statusi i

[10] Niveli statistikisht domethënës i zgjedhur prej nesh është $p < 0.05$. Në terma të thjeshtë, ky nivel nënkupton që me 95% siguri efektet e vrojtuara te mostra përfaqësojnë efekte të ngjashme në popullsinë reale. Nga ana tjetër, këto rezultate kanë 5% mundësi që të jenë gabime të pashmangshme kampionimi.

punësimit, niveli edukimit, etniciteti, statusi i paaftësisë dhe vendbanimi.

*Tabela 3: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore (Telefonatat)*

| Variabli | Kategoritë e krahasuara | Raporti i mundësive |
|---|---|---|
| Grupmoshat | 14-24\| 64+ | 1.7 |
| | 25-44\| 64+ | 1.4 |
| | 45-64\| 64+ | 1.3 |
| Gjinia | Femër\| Mashkull | 1.5 |
| Statusi i punësimit | I papunë\| I punësuar | 1.9 |
| | Pensionist\| I punësuar | 0.7 |
| Etniciteti | Roma\| Shqiptar | 2.6 |
| Statusi i paaftësisë | Me paaftësi\| Pa paaftësi | 3.1 |
| Variabla jo domethënëse (statistikisht) përfshijnë nivelin e edukimit dhe vendbanimin[11] | | |
| | | Nr. = 924 |

Një raport mundësish më i madh se 1 tregon që kategoria e parë ka më shumë shance për të hasur një problem ligjor se kategoria e dytë (kategoria e referencës) dhe anasjelltas. Vlera absolute e këtij raporti përfaqëson mundësinë që ka grupi i parë për të shkaktuar variablin e varur (në rastin tonë, të ndeshurit me një problem ligjor në 12 muajt e fundit) krahasuar me grupin e referencës. Për shembull, një raport mundësish i barabartë me 2.0 do të thotë që grupi i parë është dy herë më i predispozuar se grupi i referencës për të hasur një problem ligjor. [12] Përsa i përket Tabelës 3, raporti i parë i mundësive tregon që të rinjtë midis 14 dhe 24 vjeç kanë 1.7 herë më shumë shance se individët mbi 64 vjeç për t'u përballur me një çështje ligjore. Në këtë pikë, ju ftojmë të rikujtoni që mostra jonë përfaqëson individët me vështirësi ekonomike dhe këto marrëdhënie i referohen vetëm kësaj kategorie. Njerëzit midis 25 dhe 44 dhe ata midis 45 dhe 64 vjeç janë përkatësisht 1.4 dhe 1.3 herë më të prirur për t'u përballur me probleme ligjore se individët në moshë më të madhe. Femrat janë 50% më vulnerabël se meshkujt në këtë aspekt dhe të papunët pothuaj dyfish më të prekur se ata që janë në punë. Pjesëtarët e komunitetit Roma ndeshin mesatarisht 2.6 herë më shumë sfida se individët me origjinë shqiptare ndërsa njerëzit

[11] Niveli i domethënies statistike për këto variabla është $p > 0.05$ që nuk lejon të thuhet me siguri (95%) që ekziston një efekt.

[12] Grupet e referencës janë zgjedhur në mënyrë arbitrare për të pasur shifrat më të volitshme të mundshme, dmth., për të pasur shumicën e raporteve të mundësive më të mëdha se 1.

me paaftësi kanë shance shumë të larta të kenë probleme ligjore, më shumë se 3 herë se ata që janë plotësisht "të shëndetshëm."

Grupet më të prirura për t'u përballur me probleme ligjore ndërmjet njerëzve me vështirësi ekonomike, në rend zbritës, janë:

1. Njerëzit me paaftësi
2. Komuniteti Roma
3. Të papunët
4. Individët midis 14 dhe 24 vjeç
5. Femrat
6. Të punësuarit
7. Individët midis 25 dhe 44 vjeç
8. Individët midis 45 dhe 64 vjeç

### 4.1.3 Faktorët që Influencojnë Llojin e Problemit Ligjor të Hasur

Për të vlerësuar se cilët faktorë influencojnë çdo grup të problemeve ligjore, do të ishte e nevojshme të zhvillonim 8 regresione binare logjistike me 8 variabla të ndryshme të varura, një për secilin grup. Sidoqoftë, regresioni binar logjistik kërkon një mostër me të paktën 100 subjekte apo matje (Peduzzi et al., 1996). Për këtë arsye ne mund të shqyrtojmë vetëm grupet e problemeve lidhur me të drejtat, familjen dhe punësimin.

#### *4.1.3.1 Të drejtat, familja dhe punësimi*

*Tabela 4: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore lidhur me të drejtat (Telefonatat)*

| Variabli | Kategoritë e krahasuara | Raporti i mundësive |
|---|---|---|
| Grupmoshat | 14-24\| 64+ | 2.1 |
| | 25-44\| 64+ | 1.5 |
| | 45-64\| 64+ | 1.9 |
| Gjinia | Femër\| Mashkull | 0.9 |
| Statusi i punësimit | I papunë\| I punësuar | 2.4 |
| Etniciteti | Roma\| Shqiptar | 3.9 |
| Statusi i paaftësisë | Me paaftësi\| Pa paaftësi | 3.7 |
| Niveli i edukimit | Primar\| Universitet | 1.3 |

| Variablat jo domethënëse përfshijnë vendbanimin |
|---|
| Nr. = 322 |

Shpjegimi i këtyre raporteve nuk është i ndryshëm nga ai i dhënë për Tabelën 3. Sidoqoftë, vihet re se disa faktorë janë më të rëndësishëm (dhe më pak të rëndësishëm) për të parashikuar mundësitë e ndeshjes me një problem ligjor lidhur me të drejtat sesa ishin në lidhje me problemet ligjore në tërësi. Për shembull, anëtarët e komunitetit Roma janë 3.9 herë më vulnerabël ndaj këtij grupi problemesh krahasuar me individët me origjinë të shumicës shqiptare. Njerëzit me paaftësi ndeshen me të tilla probleme 3.7 herë më shpesh se njerëzit pa paaftësi. Grupmosha me probabilitet më të lartë për tu ndeshur me probleme ligjore lidhur me të drejtat janë të rinjtë e moshës 14-24 vjeç. Nga ana tjetër, lidhur me problemet e të drejtave meshkujt janë më vulnerabël se femrat. Një ndryshim tjetër krahasuar me Tabelën 3 është ai që një kategori e variablit "Niveli i edukimit" është kthyer në një faktor statistikisht domethënës në parashikimin e problemeve ligjore lidhur me të drejtat. Individët që nuk kishin mbaruar gjimnazin në kohën e kësaj ankete kishin 1.3 herë më shumë mundësi për t'u ndeshur me probleme ligjore lidhur me të drejtat se personat me shkollë të lartë.

Grupet më të prirura për t'u përballur me probleme ligjore të lidhura me të drejtat ndërmjet njerëzve me vështirësi ekonomike, në rend zbritës, janë:

1. Komuniteti Roma
2. Njerëzit me paaftësi
3. Të papunët
4. Individët midis 14 dhe 24 vjeç
5. Individët midis 45 dhe 64 vjeç
6. Individët midis 25 dhe 44 vjeç
7. Individët që nuk kanë përfunduar gjimnazin
8. Meshkujt

Tabelat 5 dhe 6 zhvillojnë të njëjtin hulumtim që u bë më sipër për problemet ligjore lidhur me të drejtat për problemet e lidhura me familjen dhe punësimin. Për këtë arsye, shpjegime të mëtejshme do të ishin të tepërta.

*Tabela 5: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore lidhur me familjen (Telefonatat)*

| Variabli | Kategoritë e krahasuara | Raporti i mundësive |
|---|---|---|
| Grupmoshat | 14-24\| 64+ | 1.4 |
| | 25-44\| 64+ | 1.7 |
| Gjinia | Femër\| Mashkull | 2.3 |
| Statusi i punësimit | I papunë\| I punësuar | 1.1 |
| Etniciteti | Roma\| Shqiptar | 3.5 |
| Statusi i paaftësisë | Me paaftësi\| Pa paaftësi | 1.3 |
| Variablat jo domethënëse përfshijnë nivelin e edukimit dhe vendbanimin | | |

Nr. = 211

Grupet më të prirura për t'u përballur me probleme ligjore të lidhura me familjen ndërmjet njerëzve me vështirësi ekonomike, në rend zbritës, janë:

1. Komuniteti Roma
2. Femrat
3. Individët midis 25 dhe 44 vjeç
4. Individët midis 14 dhe 24 vjeç
5. Njerëzit me paaftësi
6. Të papunët

*Tabela 6: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore lidhur me punësimin (Telefonatat)*

| Variabli | Kategoritë e krahasuara | Raporti i mundësive |
|---|---|---|
| Grupmoshat | 14-24\| 64+ | 1.9 |
| | 25-44\| 64+ | 1.8 |
| | 45-64\| 64+ | 2 |
| Gjinia | Femër\| Mashkull | 1.1 |
| Statusi i punësimit | I papunë\| I punësuar | 2.3 |
| Etniciteti | Roma\| Shqiptar | 1.7 |
| Statusi i paaftësisë | Me paaftësi\| Pa paaftësi | 1.5 |
| Variablat jo domethënëse përfshijnë nivelin e edukimit dhe vendbanimin | | |

Nr. = 125

Grupet më të prirura për t'u përballur me probleme ligjore të lidhura me familjen ndërmjet njerëzve me vështirësi ekonomike, në rend zbritës, janë:

1. Të papunët
2. Individët midis 45 dhe 64 vjeç
3. Individët midis 14 dhe 24 vjeç
4. Individët midis 25 dhe 44 vjeç
5. Komuniteti Roma
6. Njerëzit me paaftësi
7. Femrat

### 4.2 Pyetësorët

Ky seksion përsërit punën e bërë më lart për të dhënat e marra më anë të pyetësorëve. I vetmi ndryshim është se në këtë rast ne nuk studiuam përhapjen e problemeve ligjore në tërësi (dhe faktorët pas saj). Kjo e fundit do të ishte e pakuptimtë duke qenë se për të shmangur një mostër shumë jo përfaqësuese, siç u shpjegua më lart, duke parë që kampioni u mblodh në gjykatat e rretheve ne limituam kampionimin për të përfshirë vetëm ata individë që kishin ndeshur të paktën një problem ligjor 12 muajt e fundit. Ndaj përqindja e njerëzve me probleme ligjore do të ishte 100% në mostrën tonë. Sidoqoftë, raporti shqyrton subjektet me më shumë se 1 problem dhe shpërndarjen e çështjeve ligjore sipas grupeve të renditura në seksionin 3.3.

Tabela e shpërndarjes së frekuencës kumulative tregon sesi një numër i vogël subjektesh mbajnë një numër disproporcionalisht më të madh të çështjeve ligjore të hasura. Për shembull, vetëm 7.54% e individëve të kësaj mostre kanë hasur më shumë se 2 probleme vitin e shkuar por eksperiencat e tyre përfshijnë 17.7% të rasteve të gjithë grupit.

*Tabela 7: Shpërndarja e frekuencës kumulative për përhapjen e problemeve ligjore (Pyetësorët)*

| Nr. i problemeve për subjekt | Subjekte | | Probleme | |
|---|---|---|---|---|
| | Nr. | Kumulativ % | Nr. | Kumulativ % |
| 1 | 714 | 71.3 | 714 | 51.5 |
| 2 | 213 | 92.6 | 426 | 82.3 |
| 3 | 58 | 98.4 | 174 | 94.8 |
| 4 | 13 | 99.7 | 52 | 98.6 |
| 5 | 4 | 100 | 20 | 100 |
| Totali | 1002 | | 1386 | |

### 4.2.1 Klasifikimi i Problemeve Ligjore

Ky seksion ndjek të njëjtin klasifikim si ai i përdorur në seksionin 4.1.1. Tabela e mëposhtme tregon ndarjen e 1386 problemeve ligjore sipas grupeve. Grupi më i përhapur në mostrën tonë është ai i lidhur me krimet. Kjo kategori përfshin pothuaj çerekun e matjeve të mostrës. Kategori të tjera që ndeshen shpesh janë ato të lidhura me familjen dhe pronën. Në anën tjetër, çështje të banimit, të shkaktimit të dëmit dhe të drejtave janë më pak problematiket në mostrën tonë.[13]

*Tabela 8: Problemet ligjore sipas grupit (Pyetësorët)*

| Grupi | Nr. | % |
|---|---|---|
| Krime | 355 | 25.6 |
| Punësimi | 148 | 10.7 |
| Familja | 254 | 18.3 |
| Banimi | 69 | 5 |
| Para | 151 | 10.9 |
| Shkaktim dëmi | 89 | 6.4 |
| Prona | 223 | 16.1 |
| Të drejta | 97 | 7 |
| Totali | 1386 | 100 |

[13] Duke qenë se këto rezultate përputhen me statistikat që ofrojnë gjykatat e rretheve për natyrën e problemeve ligjore të ndeshura, jemi besimplotë që mostra jonë është përfaqësuese për popullsinë e individëve që kanë ndeshur të paktën një problem ligjor në vitin e fundit.

### 4.2.2 Faktorët që Influencojnë Llojin e Problemit Ligjor të Hasur

Për të vlerësuar se cilët faktorë influencojnë çdo grup të problemeve ligjore, do të ishte e nevojshme të zhvillonim 8 regresione binare logjistike me 8 variabla të ndryshme të varura, një për secilin grup. Sidoqoftë, siç u tha më lart regresioni binar logjistik kërkon një mostër me të paktën 100 subjekte apo matje. Për këtë arsye ne mund të shqyrtojmë vetëm grupet e problemeve lidhur me krimet, familjen, pronën, paratë dhe punësimin.

#### *4.2.2.1 Krime, Familja, Prona, Paratë dhe Punësimi*

*Tabela 9: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore lidhur me krimet (Pyetësorët)*

| Variabli | Kategoritë e krahasuara | Raporti i mundësive |
|---|---|---|
| Grupmoshat | 14-24\| 64+ | 1.9 |
| | 25-44\| 64+ | 1.5 |
| | 45-64\| 64+ | 1.1 |
| Gjinia | Femër\| Mashkull | 0.7 |
| Statusi i punësimit | I papunë\| I punësuar | 2.1 |
| Niveli i edukimit | Primar\| Universitet | 1.4 |
| Të ardhurat familjare | Nën mesatare\| Mbi mesatare | 1.4 |
| Statusi i paaftësisë | Me paaftësi\| Pa paaftësi | 0.5 |
| Variablat jo domethënëse përfshijnë etnicitetin | | |

Nr. = 355

Rezultatet e Tabelës 9 interpretohen në mënyrë të ngjashme me ato të seksioneve të mëparshme. Të papunët kanë 2 herë më shumë mundësi për tu përballur me probleme ligjore të lidhura me krimin, ose si viktima ose si të akuzuar.[14] Meshkujt kanë 1.4 herë më shumë shance për të ndeshur kësilloj çështjesh sesa femrat.

Grupet më të prirura për t'u përballur me probleme ligjore të lidhura me krimet ndërmjet njerëzve që kanë kaluar të paktën 1 problem ligjor vitin e fundit, në rend zbritës, janë:

1. Të papunët
2. Njerëzit me paaftësi

[14] Kini parasysh që flasim për popullsinë e njerëzve që kanë hasur të paktën një problem ligjore vitin e fundit.

3. Individët midis 14 dhe 24 vjeç
4. Individët midis 25 dhe 44 vjeç
5. Meshkujt
6. Individët me të ardhura familjare nën mesataren
7. Individët që nuk e kanë mbaruar gjimnazin
8. Individët midis 45 dhe 64 vjeç

*Tabela 10: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore lidhur me familjen (Pyetësorët)*

| Variabli | Kategoritë e krahasuara | Raporti i mundësive |
|---|---|---|
| Grupmoshat | 14-24\| 64+<br>25-44\| 64+ | 0.8<br>1.6 |
| Gjinia | Femër\| Mashkull | 1.9 |
| Statusi i punësimit | I papunë\| I punësuar | 1.8 |
| Etniciteti | Roma\| Shqiptar | 1.3 |
| Të ardhurat familjare | Nën mesatare\| Mbi mesatare | 1.7 |
| Variablat jo domethënëse përfshijnë nivelin e edukimit dhe statusin e paaftësisë | | |

Nr. = 254

Grupet më të prirura për t’u përballur me probleme ligjore të lidhura me familjen ndërmjet njerëzve që kanë kaluar të paktën 1 problem ligjor vitin e fundit, në rend zbritës, janë:

1. Femrat
2. Të papunët
3. Individët me të ardhura familjare nën mesataren
4. Individët midis 25 dhe 44 vjeç
5. Komuniteti Roma
6. Individët mbi 64 vjeç

*Tabela 11: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore lidhur me pronën (Pyetësorët)*

| Variabli | Kategoritë e krahasuara | Raporti i mundësive |
|---|---|---|
| Grupmoshat | 14-24\| 64+ | 0.8 |
| | 25-44\| 64+ | 1.3 |
| | 45-64\| 64+ | 1.6 |
| Gjinia | Femër\| Mashkull | 0.4 |
| Etniciteti | Roma\| Shqiptar | 0.3 |
| Statusi i paaftësisë | Me paaftësi\| Pa paaftësi | 0.7 |
| Variablat jo domethënëse përfshijnë nivelin e edukimit, statusin e punësimit dhe të ardhurat familjare | | |
| | | Nr. = 223 |

Grupet më të prirura për t'u përballur me probleme ligjore të lidhura me pronën ndërmjet njerëzve që kanë kaluar të paktën 1 problem ligjor vitin e fundit, në rend zbritës, janë:

1. Individët me origjinë shqiptare
2. Meshkujt
3. Individët midis 45 dhe 64 vjeç
4. Njerëzit me paaftësi
5. Individët midis 25 dhe 44 vjeç
6. Individët mbi 64 vjeç

*Tabela 12: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore lidhur me paratë (Pyetësorët)*

| Variabli | Kategoritë e krahasuara | Raporti i mundësive |
|---|---|---|
| Grupmoshat | 14-24\| 64+ | 0.9 |
| | 25-44\| 64+ | 1.1 |
| Statusi i punësimit | I papunë\| I punësuar | 1.5 |
| Të ardhurat familjare | Nën mesatare\| Mbi mesatare | 1.6 |
| Variablat jo domethënëse përfshijnë gjininë, etnicitetin, nivelin e edukimit dhe statusin e paaftësisë | | |
| | | Nr. = 151 |

Grupet më të prirura për t'u përballur me probleme ligjore të lidhura me paratë ndërmjet njerëzve që kanë kaluar të paktën 1 problem ligjor vitin e fundit, në rend zbritës, janë:

1. Individët me të ardhura familjare nën mesataren
2. Të papunët
3. Individët midis 25 dhe 44 vjeç
4. Individët mbi 64 vjeç

*Tabela 13: Përmbledhje e regresionit përsa i përket ndeshjes me probleme ligjore lidhur me punësimin (Pyetësorët)*

| Variabli | Kategoritë e krahasuara | Raporti i mundësive |
|---|---|---|
| Grupmoshat | 14-24\| 64+ | 1.2 |
| | 25-44\| 64+ | 1.7 |
| | 45-64\| 64+ | 1.5 |
| Gjinia | Femër\| Mashkull | 1.4 |
| Etniciteti | Roma\| Shqiptar | 0.8 |
| Të ardhura familjare | Nën mesatare\| Mbi mesatare | 1.2 |
| Statusi i paaftësisë | Me paaftësi\| Pa paaftësi | 1.2 |
| Variablat jo domethënëse përfshijnë nivelin e edukimit dhe statusin e punësimit | | |

Nr. = 148

Grupet më të prirura për t'u përballur me probleme ligjore të lidhura me punësimin ndërmjet njerëzve që kanë kaluar të paktën 1 problem ligjor vitin e fundit, në rend zbritës, janë:

1. Individët midis 25 and 44 vjeç
2. Individët midis 45 and 64 vjeç
3. Femrat
4. Komuniteti Roma
5. Individët me të ardhura familjare nën mesataren
6. Njerëzit me paaftësi
7. Individët midis 14 and 24 vjeç

# 5. Pasojat Negative të Problemeve Ligjore

## 5.1 Telefonatat

Subjektet u pyetën për efektet e mundshme negative që këto çështje ligjore kishin shkaktuar në jetën e tyre të përditshme. Gjatë telefonatave ne i lejuam të anketuarëve t'i përshkruanin këto efekte me fjalët e tyre dhe më pas i klasifikuam në katër kategori: asnjë efekt, efekte të lehta, mesatare dhe të rënda. Nga 695 persona që ishin ndeshur me një problem ligjor vitin e fundit, 37 nuk raportuan asnjë efekt, 215 efekte të lehta, 278 mesatare dhe 165 të rënda.

*Figura 8: Efekte negative shkaktuar nga Problemet Ligjore (Telefonatat)*




Figura 9 tregon sesi këto efekte ndahen për secilin nga grupet e problemeve. Ashtu si pritej, të gjithë individët që kanë hasur një problem ligjor lidhur me krime kanë raportuar disa komplikacione në jetën e përditshme. Çështjet e lidhura me paratë dhe banimin prodhojnë efekte relativisht më pak të rënda.

*Figura 9: Pasojat negative të problemeve ligjore sipas grupit të problemit (Telefonatat)*[15]




[15] Një lexues i kujdesshëm mund të shikojë që shuma e të gjithë grupeve në këtë figurë është 924 ndërkohë që në paragrafin pararendës ne përmendëm 695 matje, një për çdo subjekt. Në këtë pikë duhet të rikujtoni që disa nga të anketuarit ishin ndeshur me më shumë se 1 problem dhe në këto raste ne i pyetëm të jepnin një vlerësim mesatar të pasojave në jetën e përditshme.

## 5.2 Pyetësorët

Në mënyrë të ngjashme, pyetja 20 e pyetësorit i kërkon subjekteve të vlerësojnë ndërlikimet që problemi apo problemet ligjore kanë sjellur në jetën e tyre të përditshme. Ashtu si për telefonatat, ne i kërkuam të anketuarve t'a klasifikonin përgjigjjen në një spektër me katër alternativa. Nga 1002 persona, 144 nuk raportuan asnjë efekt, 299 efekte të lehta, 340 mesatare dhe 219 të rënda.

*Figura 10: Efekte negative shkaktuar nga Problemet Ligjore (Pyetësorët)*




Figura 11 tregon sesi këto efekte ndahen për secilin nga grupet e problemeve. Rezultatet e mostrës sonë konfirmojnë që njerëzit që janë ndeshur me të paktën një problem ligjor vitin e fundit dëmtohen më shumë nga çështje të lidhura me krimet dhe pronat sesa ato me banimin apo paratë.

*Figura 11: Pasojat negative të problemeve ligjore sipas grupit të problemit (Pyetësorët)*




# 6. Strategjitë e Përdorura për Problemet Ligjore

## 6.1 Telefonatat

Pas vlerësimit të çështjeve ligjore me të cilat subjektet e mostrës sonë janë përballur vitin e kaluar, ky kapitull fokusohet në strategjitë përkatëse në përgjigje të këtyre problemeve. Ne i kategorizojmë këto përgjigjje në tre grupe kryesore:

1. Kërkim i ndihmës ligjore nga një person tjetër
    a. Avokat me pagesë
    b. Avokat kryesisht
    c. Avokat pa pagesë (mik ose i afërm)
    d. OJQ që ofrojnë ndihmë juridike falas
2. Vetë-ndihmë (apo vetë-informim me anë të internetit ose librave të ndryshëm)
3. Asnjë veprim

Shpërndarja e 695 përgjigjeve sipas këtyre kategorive reflektohet në tabelën më poshtë. Fatmirësisht (duke qenë se e bën më të lehtë përfaqësimin e të dhënave), të gjithë personat me më shumë së një problem ligjor ne vitin e fundit në këtë mostër kanë ndjekur të njëjtën strategji për të gjitha çështjet. Kampioni ynë tregon se vetëm 5 njerëz kanë punësuar një avokat me pagesë — fakt që përputhet plotësisht me kushtin që ne zgjodhëm për vetë-identifikimin e njerëzve me vështirësi ekonomike si individë që nuk mund të përballonin një problem ligjor. Afro 26% e të anketuarve kanë kërkuar ndihmë ligjore nga persona të tjerë — shumica e tyre (17.5%) nga OJQ që ofrojnë shërbime ligjore falas. Një grup tjetër prej 26% janë përpjekur t'i zgjidhin vetë shqetësimet ligjore dhe një numër "frikësues" që përbën 48% të totalit nuk ka ndërmarrë asnjë strategji për të adresuar problemet e tyre.

*Tabela 14: Lloji i përgjigjes ndaj problemeve ligjore (Telefonatat)*

| Lloji i përgjigjes | Nr. |
|---|---|
| Kërkim i ndihmës ligjore nga një person tjetër | |
| Avokat me pagesë | 5 |
| Avokat kryesisht | 48 |
| Avokat pa pagesë (mik ose i afërm) | 9 |
| OJQ | 122 |
| Vetë-ndihmë | 179 |
| Asnjë veprim | 332 |
| Totali | 695 |

*Figura 12: Përgjigjjet ndaj problemeve ligjore sipas grupit të problemeve (Telefonatat)*




## 6.1.1 Faktorët Demografikë dhe Socioekonomikë që Influencojnë Përgjigjjet ndaj Problemeve Ligjore

Seksioni 6.1 tregoi sesi vetëm një grup i vogël i njerëzve në vështirësi ekonomike kërkon ndihmë ligjore nga jashtë për t'u përballur me problemet e tyre. Për këtë arsye ky seksion dhe tjetri në vazhdim do të analizojnë arsyet pas këtij fenomeni. Si fillim do të përdorim një regresion binar logjistik, ashtu si në Kapitullin 4, për të shqyrtuar faktorët demografikë dhe

socioekonomikë. Seksioni tjetër merret me pengesat logjistike dhe arsyet personale, të cilat zbulohen nga pyetjet e tjera të anketës, që shtyjnë drejt kësaj zgjedhje.

Regresioni binar logjistik përdor si variabël të varur përgjigjen ndaj problemeve ligjore. Kjo variabël u kodua si binare duke diferencuar midis njerëzve që kërkojnë ndihmë ligjore të jashtme dhe atyre që nuk kërkojnë, duke përfshirë kategoritë e “vetë-ndihmës” dhe “asnjë veprimi.” Variablat e pavarura janë ato të Kapitullit 4, mosha, gjinia, statusi i punësimit, niveli i edukimit, statusi i paaftësisë, etniciteti dhe vendbanimi. Niveli statistikisht domethënës i zgjedhur është $p < 0.05$ që për t’a rikujtuar nënkupton se me 95% siguri efektet e vrojtuara te mostra përfaqësojnë efekte të ngjashme në popullsinë reale.

*Tabela 15: Përmbledhje e regresionit përsa i përket përgjigjjeve ndaj problemeve ligjore (Telefonatat)*

| Variabli | Kategoritë e krahasuara | Raporti i mundësive |
|---|---|---|
| Grupmoshat | 14-24\| 64+ | 1.3 |
| Gjinia | Femër\| Mashkull | 1.4 |
| Statusi i punësimit | I papunë\| I punësuar | 1.7 |
| | Pensionist\| I punësuar | 1.1 |
| Etniciteti | Roma\| Shqiptar | 2.3 |
| Statusi i paaftësisë | Me paaftësi\| Pa paaftësi | 1.4 |
| Niveli i edukimit | Primar\| Universitet | 1.9 |
| Vendbanimi | Jashtë Tirane\| Tiranë | 1.5 |

Nr. = 924

Si rifreskim, një raport mundësish më i madh se një tregon që kategoria e parë ka më shumë mundësi për të arritur variablën e varur sesa kategoria e dytë (kategoria e referencës) dhe anasjelltas. Duke pasur parasysh zgjedhjen tonë të kategorive të referencës nga regresionet e mëparshme dhe për të mos ngatërruar lexuesin me raporte më të vogla se një vendosëm të rikodojmë variablën e varur. Për këtë arsye, raportet e mundësive në Tabelën 15 reflektojnë shancet për të mos kërkuar ndihmë ligjore nga persona të tjerë. E kundërta (probabiliteti për të kërkuar ndihmë të jashtme ligjore) mund të llogaritet duke pjesëtuar një me secilën nga raportet e mundësive.

Tabela 15 tregon se njerëzit e komunitetit Roma janë 2.3 herë më të predispozuar për të mos kërkuar ndihmë krahasuar me njerëzit me origjinë shqiptare. Njerëzit që banojnë jashtë Tirane kanë 1.5 herë më shumë shance sesa ata që banojnë në Tiranë për mos kërkuar ndihmë të jashtme ligjore. Grupet më të prirura për të mos kërkuar ndihmë të jashtme ligjore ndërmjet njerëzve me vështirësi ekonomike, në rend zbritës, janë:

1. Komuniteti Roma
2. Individët që nuk kanë përfunduar gjimnazin
3. Të papunët
4. Njerëzit me vendbanim jashtë Tirane
5. Femrat
6. Njerëzit me paaftësi
7. Individët midis 14 dhe 24 vjeç
8. Pensionistët

### 6.1.2 Faktorët Logjistikë që Influencojnë Përgjigjet ndaj Problemeve Ligjore

Të anketuarit që nuk kishin kërkuar ndihmë ligjore për problemet e tyre (Nr. = 511) iu adresuan pyetje të tjera për të zbuluar arsyet e kësaj zgjedhje. Si fillim, ato u pyetën të tregonin me fjalët e tyre motivimin pas këtij vendimi. Këto arsye u klasifikuan në pesë kategori:

1. I/E aftë për t'a zgjidhur vetë
2. Mungesë burimesh financiare
3. Mungesë besimi tek institucionet që ofrojnë ndihmë ligjore
4. Çështjet nuk ishin aq të rëndësishme për të kërkuar ndihmë
5. Mundësi të pakta për të fituar

Grafiku më poshtë paraqet llojet e motivimeve që shtynë këta individë për të mos kërkuar ndihmë. Shumica e rasteve nuk u adresua në mënyrën e duhur për shkak të limitimeve financiare. Arsye e dytë më e përhapur për të ndërrmarrë këtë rrugë ishte mungesa e besimit te institucionet përkatëse. Aftësia për t'a zgjidhur vetë, mundësitë e pakta për t'a fituar apo mosrëndësia e problemit nuk ishin arsye të qenësishme duke qenë se ato shpjegojnë vetëm 9% të rasteve.

*Figura 13: Arsyet për të mos kërkuar ndihmë ligjore (Telefonatat)*[16]




Ky studim shkoi një hap më tej dhe pyeti subjektet që u përgjigjën me “mungesë burimesh financiare” pyetjes së mësipërme nëse kishin dijeni për mundësitë për të përfituar ndihmë juridike falas nga shteti apo OJQ përkatëse. Siç tregon Figura 14, më shumë se 60% e këtyrë të anketuarve nuk kishin informacion (apo kishin informacion të limituar) për asnjërën nga këto struktura. Në anën tjetër, pothuaj 12% e të pyeturve kishin dijeni për mundësitë e

[16] Mostra e treguar nga ky grafik është më e madhe se 511 matje (774) për shkak se disa individë përballen me më shumë se një problem dhe për shkak se disa individë mund të motivohen nga më shumë se një arsye për vendimin e tyre.

ofruara nga të dy llojet e institucioneve, 16% vetëm për avokatët kryesisht dhe 8% vetëm për OJQ që ofrojnë ndihmë ligjore falas.

*Figura 14: Informacion mbi institucionet që ofrojnë ndihmë ligjore falas (Telefonatat)*




## 6.2 Pyetësorët

Pyetjet 15 dhe 16 të pyetësorit kërkojnë informacion mbi strategjitë e përdorura nga të anketuarit në përgjigje të problemeve ligjore të hasura përgjatë dymbëdhjetë muajve të fundit. Duke përdorur të dhënat e marra nga telefonatat, ne vendosëm alternativat e mëposhtme për të zgjedhur midis tyre:

1. Kërkim i ndihmës ligjore nga një person tjetër
    a. Avokat me pagesë
    b. Avokat kryesisht

c. Avokat pa pagesë (mik ose i afërm)
d. OJQ që ofrojnë ndihmë ligjore falas
2. Vetë-ndihmë (apo vetë-informim me anë të internetit ose librave të ndryshëm)
3. Asnjë veprim

Tabela 16 na tregon se ndryshe nga njerëzit me vështirësi ekonomike, individët që janë ndeshur me të paktën një problem ligjor vitin e fundit kanë si strategji më të përhapur marrjen e një avokati me pagesë. Individët në pothuaj 40% e rasteve të identifikuara[17] iu drejtuan një avokati privat. Avokatët kryesisht u kërkuan në më shumë se 10% të rasteve dhe në "vetëm" 42% të çështjeve nuk u kërkua ndihmë ligjore. Midis këtyre të fundit, 21.7% i besuan një strategjie të ndërtuar vetë dhe 20.7% nuk ndërmorrën asnjë masë në përgjigje të problemeve të tyre.

*Tabela 16: Lloji i përgjigjes ndaj problemeve ligjore (Pyetësorët)*

| Lloji i përgjigjes | Nr. |
|---|---|
| Kërkim i ndihmës ligjore nga një person tjetër | |
| Avokat me pagesë | 550 |
| Avokat kryesisht | 148 |
| Avokat pa pagesë (mik ose i afërm) | 12 |
| OJQ | 88 |
| Vetë-ndihmë | 301 |
| Asnjë veprim | 287 |
| Totali | 1386 |

[17] Në këtë rast flasim për raste jo për individë duke qenë se disa njerëz me më shumë se një problem ligjor në mostrën tonë kanë treguar se kanë përdorur strategji të ndryshme për probleme të ndryshme (ndryshe nga sa u pohua nga të anketuarit në kampionin tjetër).

*Figura 15: Përgjigjjet ndaj problemeve ligjore sipas grupit të problemeve (Pyetësorët)*




## 6.2.1 Faktorët Demografikë dhe Socioekonomikë që Influencojnë Përgjigjjet ndaj Problemeve Ligjore

Ashtu si në seksionin 6.1.1, ne përdorim regresione binare logjistike për të vlerësuar efektet e faktorëve demografikë dhe socioekonomikë në strategjitë e përdorura në përgjigje të

problemeve ligjore. Regresioni binar logjistik përdor si variabël të varur përgjigjen ndaj problemeve ligjore. Kjo variabël u kodua si binare duke diferencuar midis njerëzve që kërkojnë ndihmë ligjore të jashtme dhe atyre që nuk kërkojnë, duke përfshirë kategoritë e "vetë-ndihmës" dhe "asnjë veprimi." Variablat e pavarura janë ato të Kapitullit 4, mosha, gjinia, statusi i punësimit, niveli i edukimit, statusi i paaftësisë, etniciteti dhe niveli i të ardhurave familjare. Niveli statistikisht domethënës i zgjedhur është $p < 0.05$ që për t'a rikujtuar nënkupton se me 95% siguri efektet e vrojtuara te mostra përfaqësojnë efekte të ngjashme në popullsinë reale.

*Tabela 17: Përmbledhje e regresionit përsa i përket përgjigjjeve ndaj problemeve ligjore (Pyetësorët)*

| Variabli | Kategoritë e krahasuara | Raporti i mundësive |
|---|---|---|
| Gjinia | Femër\| Mashkull | 1.1 |
| Statusi i punësimit | I papunë\| I punësuar | 1.9 |
| Etniciteti | Roma\| Shqiptar | 3.2 |
| Statusi i paaftësisë | Me paaftësi\| Pa paaftësi | 2.1 |
| Të ardhurat familjare | Nën mesatare\| Mbi mesatare | 2.4 |
| Variablat jo domethënëse përfshijnë moshën dhe nivelin e edukimit | | |

Nr. = 1386

Ashtu si në Tabelën 15, duke parë zgjedhjen e kategorive të referencës dhe për të mos ngatërruar lexuesin me raporte më të vogla se një vendosëm të rikodojmë variablën e varur. Për këtë arsye, raportet e mundësive në Tabelën 17 reflektojnë shancet për të mos kërkuar ndihmë ligjore nga persona të tjerë. E kundërta (probabiliteti për të kërkuar ndihmë të jashtme ligjore) mund të llogaritet duke pjesëtuar një me secilën nga raportet e mundësive.

Grupet më të prirura për të mos kërkuar ndihmë të jashtme ligjore ndërmjet njerëzve që kanë hasur të paktën një problem ligjor vitin e fundit, në rend zbritës, janë:

1. Komuniteti Roma
2. Individët me të ardhura familjare nën mesataren
3. Njerëz me paaftësi
4. Të papunët
5. Femrat

### 6.2.2 Faktorët Logjistikë që Influencojnë Përgjigjet ndaj Problemeve Ligjore

Pyetjet nr. 17-19 të pyetësorit përpiqen të hulumtojnë arsyet që mund të kenë shtyrë subjektet për të mos kërkuar ndihmë ligjore për problemet e tyre. Grafiku i mëposhtëm paraqet një pikturë të plotë të këtyre mekanizmave. Nga 588 raste për të cilat nuk është kërkuar ndihmë, më shumë se gjysma (312) janë nxitur nga limitime financiare. Nga ky numër, vetëm 34% (106) nuk kishin dijeni (ose kishin informacion të pjesshëm) për institucione që ofrojnë ndihmë ligjore falas, avokatët kryesisht ose OJQ-të.

*Figura 16: Arsyet për të mos kërkuar ndihmë ligjore (Pyetësorët)*



*Figura 17: Informacion mbi institucionet që ofrojnë ndihmë ligjore falas (Pyetësorët)*




# 7. Finalizimi i Problemeve Ligjore

Pyetja e fundit që adresohet nga kjo anketë lidhet me përfundimin e çështjeve ligjore. Sa nga ato u finalizuan? Sa u zgjidhën për secilin grup problemesh? Cilët faktorë ndikuan në përfundimin ose jo të tyre? Këto janë disa nga pyetjet të cilave Kapitulli 7 kërkon t'i përgjigjet.

## 7.1 Telefonatat

Nga 695 individë që kanë hasur të paktën një problem ligjor vitin e fundit, vetëm 148 prej tyre kanë arritur t'i zgjidhin të gjithë problemet e tyre. 27 nga të anketuarit kanë pohuar që kanë zgjidhur vetëm një pjesë të problemeve dhe një shumicë dërrmuese, 520 subjekte, pohuan që nuk ishin në gjendje të zgjidhnin asnjë nga shqetësimet.

*Figura 18: Zgjidhja e problemeve ligjore (Telefonatat)*



*Figura 19: Zgjidhja e problemeve ligjore sipas grupit të problemeve (Telefonatat)*




### 7.1.1 Faktorët që Influencojnë Zgjidhjen e Problemeve Ligjore

Ashtu si me përhapjen e problemeve ligjore dhe përgjigjjet ndaj tyre, ky seksion përdor një analizë multivariabël për të analizuar faktorët që influencojnë finalizimin e problemeve ligjore. Regresioni binar logjistik përdor si variabël të varur zgjidhjen e problemeve ligjore. Kjo variabël u kodua si binare duke diferencuar midis çështjeve të zgjidhura dhe atyre të pazgjidhura. Variablat e pavarura përfshijnë moshën, gjininë, statusin e punësimit, nivelin e edukimit, statusin e paaftësisë, etnicitetin, vendbanimin dhe variablën e varur të Kapitullit 6, të kërkuarit ose jo të

ndihmës ligjore. Kjo e fundit u përfshi si variabël e pavarur në këtë regresion duke qenë se ne besojmë që individët që kërkojnë ndihmë ligjore kanë më shumë mundësi për të zgjidhur problemet e tyre ligjore. Niveli statistikisht domethënës i zgjedhur është $p < 0.05$.

*Tabela 18: Përmbledhje e regresionit përsa i përket finalizimit të problemeve ligjore (Telefonatat)*

| Variabli | Kategoritë e krahasuara | Raporti i mundësive |
|---|---|---|
| Grupmoshat | 14-24\| 64+ | 1.3 |
| | 25-44\| 64+ | 1.1 |
| Strategjia e përdorur | Kërkim i ndihmës ligjore\| Moskërkim i ndihmës ligjore | 2.7 |
| Statusi i punësimit | I papunë\| I punësuar | 1.3 |
| Etniciteti | Roma\| Shqiptar | 1.7 |
| Niveli i edukuimit | Primar\| Universitet | 1.8 |
| | Sekondar\| Universitet | 1.4 |
| Variablat jo domethënës përfshijnë vendbanimin, statusin e paaftësisë dhe gjininë | | |

Nr. = 924

Duke parë zgjedhjen e kategorive të referencës dhe për të mos ngatërruar lexuesin me raporte më të vogla se një vendosëm të rikodojmë variablën e varur. Për këtë arsye, raportet e mundësive në Tabelën 18 reflektojnë shancet për të mos i zgjidhur problemet ligjore. E kundërta (probabiliteti për t’i zgjdhur çështjet ligjore) mund të llogaritet duke pjesëtuar një me secilën nga raportet e mundësive.

Grupet më të prirura për të mos i finalizuar problemet ligjore ndërmjet njerëzve me vështirësi ekonomike, në rend zbritës, janë:

1. Njerëzit që nuk kërkojnë ndihmë ligjore
2. Individët që nuk kanë përfunduar gjimnazin
3. Komuniteti Roma
4. Individët që kanë përfunduar gjimnazin por jo universitetin
5. Të papunët
6. Individët midis 14 dhe 24 vjeç
7. Individët midis 25 dhe 44 vjeç

## 7.2 Pyetësorët

Nga 1002 individë që kanë hasur të paktën një problem ligjor vitin e fundit, pjesa më e madhe, 498 tregon se i ka zgjidhur të gjithë problemet, 93 nga të anketuarit kanë pohuar që kanë zgjidhur vetëm një pjesë të problemeve ndërsa 411 individë nuk ishin në gjendje të zgjidhnin asnjë nga shqetësimet.

*Figura 20: Zgjidhja e problemeve ligjore (Pyetësorët)*



*Figura 21: Zgjidhja e problemeve ligjore sipas grupit të problemeve (Pyetësorët)*




### 7.2.1 Faktorët që Influencojnë Zgjidhjen e Problemeve Ligjore

Ashtu si me përhapjen e problemeve ligjore dhe përgjigjjet ndaj tyre, ky seksion përdor një analizë multivariabël për të analizuar faktorët që influencojnë finalizimin e problemeve ligjore. Regresioni binar logjistik përdor si variabël të varur zgjidhjen e problemeve ligjore. Kjo variabël u kodua si binare duke diferencuar midis çështjeve të zgjidhura dhe atyre të pazgjidhura. Variablat e pavarura përfshijnë moshën, gjininë, statusin e punësimit, nivelin e edukimit, statusin

e paaftësisë, etnicitetin, të ardhurat familjare dhe variablën e varur të Kapitullit 6, të kërkuarit ose jo të ndihmës ligjore. Niveli statistikisht domethënës i zgjedhur është $p < 0.05$.

*Tabela 19: Përmbledhje e regresionit përsa i përket finalizimit të problemeve ligjore (Pyetësorët)*

| Variabli | Kategoritë e krahasuara | Raporti i mundësive |
|---|---|---|
| Grupmoshat | 14-24\| 64+ | 1.3 |
| Strategjia e përdorur | Kërkim i ndihmës ligjore\| Moskërkim i ndihmës ligjore | 1.9 |
| Etniciteti | Roma\| Shqiptar | 1.6 |
| Të ardhurat familjare | Nën mesatare\| Mbi mesatare | 2.2 |
| Variablat jo domethënëse përfshijnë statusin e paaftësisë, nivelin e edukimit, statusin e punësimit dhe gjininë. | | |

Nr. = 1386

Duke parë zgjedhjen e kategorive të referencës dhe për të mos ngatërruar lexuesin me raporte më të vogla se një vendosëm të rikodojmë variablën e varur. Për këtë arsye, raportet e mundësive në Tabelën 19 reflektojnë shancet për të mos i zgjidhur problemet ligjore. E kundërta (probabiliteti për t'i zgjdhur çështjet ligjore) mund të llogaritet duke pjesëtuar një me secilën nga raportet e mundësive.

Grupet më të prirura për të mos i finalizuar problemet ligjore ndërmjet njerëzve që kanë hasur të paktën një problem ligjor vitin e fundit, në rend zbritës, janë:

1. Individët me të ardhura familjare nën mesataren
2. Njerëzit që nuk kërkojnë ndihmë ligjore
3. Komuniteti Roma
4. Individët midis 14 dhe 24 vjeç

# 8. Konkluzione: Një Qasje Tërësore ndaj Aksesit në Drejtësi

Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte të vlerësonte nevojat ligjore të qytetarëve shqiptarë nëpërmjet telefonatave dhe pyetësorëve. Ky raport përfaqëson studimin, deri më tani, mtë të plotë kualitativ dhe kuantitativ në këtë drejtim në Shqipëri. Duke përdorur instrumente të ndryshme statistikore, ai paraqet karakteristikat më të rëndësishme të përhapjes dhe natyrës së problemeve ligjore në Shqipëri, strategjitë e përdorura si përgjigje, finalizimin dhe pasojat e tyre. Kjo anketë tregon se përhapja, strategjitë, finalizimi dhe ndërlikimet e dhe si pasojë të problemeve ligjore janë heterogjene. Ndaj, kjo shumëllojshmëri nënkupton që asnjë strategji e vetme është e mjaftueshme për të sjellë drejtësi për të gjithë njerëzit. Qasja ndaj një drejtësie gjithëpërfshirëse duhet të jetë shumëanshme dhe duhet të integrojë një sërë strategjish që duhet t'i përgjigjen nevojave të ndryshme.

Pavarësisht kësaj shumëllojshmërie, ky studim ripohon që aksesi në drejtësi për njerëzit në nevojë duhet të mbesë një prioritet. Njerëzit me vështirësi ekonomike ngelen vulnerabël ndaj problemeve ligjore duke qenë se 70% e të anketuarve nga ky grup ka përjetuar një shqetësim të këtij tipi vitin e fundit. Veçanërisht komuniteti Roma, njerëzit me paaftësi dhe femrat janë grupet që hasin më shumë problematika. Jo vetëm janë të varfërit më të prekur nga problemet ligjore por ata kanë dhe më shumë mundësi për të vuajtur nga këto probleme. 95% e atyre që kishte hasur një problem ligjor 12 muajt e fundit vlerësuan që këto çështje kishin sjellur pasoja negative në jetën e tyre dhe pothuaj çereku i renditën këto ndërlikime si të rënda.

Një pjesë e këtyre vështirësive krijohet nga mungesa e ndihmës ligjore. Me anë të regresioneve binare logjistike ne vumë re një lidhje të fortë midis mungesës së ndihmës ligjore dhe pamundësisë për të finalizuar një problem ligjor. Numri i njerëzve me vështirësi ekonomike që nuk kishin kërkuar ndihmë ligjore për problemet e tyre ishte tmerrësisht i lartë. Në fakt, vetëm 26% e subjekteve u përgjigjën se kishin kërkuar ndihmë. Në mes të këtyre, grupet që priren më shumë për të mos kërkuar asistencë ligjore janë komuniteti Roma, individët që nuk kanë përfunduar gjimnazin, të papunët dhe njerëzit që banojnë jashtë Tirane. Arsyeja kryesore pas kësaj zgjedhje ishte mungesa e burimeve financiare, që shpjegon 61% të rasteve kur ndihma ligjore nuk u kërkua. 30% e rasteve të tjera u nxit nga mungesa e besimit të institucionet që ofrojnë ndihmë ligjore (duke përfshirë avokatë me pagesë dhe kryesisht dhe OJQ).

Përveç këtyre anketave kuantitative, ky raport analizoi situatën e nevojave ligjore të njerëzve në vështirësi duke zhvilluar intervista dhe fokus grupe. Këto të fundit plotësuan në mënyrë koherente tregimin mbi nevojat ligjore të ofruar nga telefonatat dhe pyetësorët dhe shtuan opinione personale më të thelluara mbi problemet dhe zgjidhjet e mundshme të sistemit të ndihmës juridike. Si pjesë e reformës në drejtësi, ligji i ri mbi ndihmën juridike ka prodhuar sinjale inkurajuese që situata mund të ndryshojë ndjeshëm në të ardhmen e afërt. Kushte më pak shtrënguese për përfituesit e mundshëm të ndihmës juridike sekondare dhe më shumë ofrues të ndihmës juridike primare mund të përmirësojnë gjendjen ekzistuese. Intervistat me përfaqësues të nivelit të lartë legjislativ dhe ekzekutiv mbështetën tezën tonë, dmth., situata juridike e shumë njerëzve, sidomos atyre në vështirësi ekonomike, është e rrezikshme dhe reforma në drejtësi synon të përmirësojë sasinë dhe cilësinë e ndihmës juridike së ofruar.

Sidoqoftë, dy pika të tjera duhet të adresohen më me kujdes. Së pari, mungesa (ose mungesa e pjesshme) e informacionit mbi ofruesit e ndihmës juridike falas mund të jetë një pengesë e rëndësishme për zgjidhjet efektive të problemeve ligjore. Më shumë se 63% e individëve që nuk kanë kërkuan ndihmë ligjore për shkak të problemeve financiare nuk kishin dijeni (ose kishin dijeni të paplotë) për mundësitë e përfitimit të ndihmës juridike falas nga shteti ose OJQ përkatëse. Ndaj, për grupet vulnerabël, fushata informuese dhe edukimi që i ndihmojnë të identifikojnë problemet e tyre ligjore dhe rrugët e zgjidhjes (qoftë dhe të kërkimit të ndihmës juridike) mund të jenë të dobishme. Në këtë drejtim, projekti i ri i Ministrisë së Drejtësisë (ngritja e një zyre pilot të specializuar në ofrimin e ndihmës juridike brenda Ministrisë) mund të jetë hapi i parë i një skeme të përmirësuar komunikimi.

Së dyti, shumëllojshmëria e problemeve ligjore, e finalizimit të tyre dhe pasojat përkatëse kërkojnë një qasje tërësore, e shumëanshme dhe e integruar, ndaj aksesit në drejtësi. Duhet të jetë e shumëanshme për të përfshirë disa lloje strategjish për të akomoduar nevoja të ndryshmë të komunitetit. Duhet të jetë e integruar për të ofruar asistencë intensive për shërbime juridike dhe ekstra-juridike duke parë që dhe nevojat e shkaktuara nga problemet ligjore mund të kërkojnë ndihmë ekstra-ligjore. Ofruesit e asistencës juridike parësore duhet të kenë dijeni për këtë shumëllojshmëri nevojash dhe të veprojnë në mënyrë të përshtatshme.

Për shembull, studime të tjera të zhvilluara mbi nevojat ligjore të vendeve të tjera sugjerojnë që ndihma juridike parësore është veçanërisht efektive për individë që kanë

informacion dhe aftësi ligjore(Coumarelos and Ramsey 2012).[18] Nga ana tjetër, individë pak të arsimuar përfitojnë më mirë nëse përfaqësohen drejtpërdrejtë nga avokatë kryesisht.

Diagnoza e saktë e rasteve të veçanta është e rëndësishme jo vetëm për mirëqenien e individit por edhe për shpërndarjen optimale të burimeve në dispozicion. Fondet e limituara financiare janë kryesisht pengesa kryesore për ofrimin e ndihmës juridike falas në sasinë dhe cilësinë e dëshiruar. Për më tepër, Sekretarja e Komisionit të Ligjeve, të Drejtave të Njeriut dhe Administrimit Publik në Parlament, Znj. Klotilda Ferhati pohoi se përmirësimet në sistemin e ndihmës juridike pritet të sjellin kosto të larta, të cilat priten të mbulohen nga tarifa më të larta gjyqësore. Prandaj, përcaktimi i prioriteteve për të optimizuar strategjitë për lehtësimin e zgjidhjeve ligjore është jetësor.

[18] Kjo do të ishte një marrëdhënie interesante për t'u testuar por që fatkeqësisht nuk mund të realizohej në këtë studim. Për të vlerësuar sesi edukimi ndërvepron me vetë-ndihmën në finalizimin e problemeve ligjore kërkohet shqyrtimi i efekteve të kombinuara të variablave të pavarura. Kjo gjë do të ishte e pamundur në rastin tonë duke parë madhësinë e kampionit.

# Aneksi 1

## Kampioni i Plotë nga Telefonatat

*Legjenda e Tabelës*

Grupmoshat

- 14-24 → Subjekti është midis 14 dhe 24 vjeç.
- 25-44 → Subjekti është midis 25 dhe 44 vjeç.
- 45-64 → Subjekti është midis 45 dhe 64 vjeç.
- 64+ → Subjekti është mbi 64 vjeç.

Gjinia

- M → Subjekti vetë-identifikohet si mashkull.
- F → Subjekti vetë-identifikohet si femër.

Niveli i edukimit

- P → Subjekti nuk ka mbaruar gjimnazin.
- S → Subjekti ka mbaruar gjimnazin por jo universitetin.
- U → Subjekti ka mbaruar të paktën universitetin.

Statusi i punësimit

- U → Subjekti është i papunë.
- E → Subjekti është i punësuar.
- R → Subjekti është pensionist.
- S → Subjekti është student.

Etniciteti

- A → Subjekti vetë-identifikohet si pjesëtar i komunitetit Shqiptar.
- R → Subjekti vetë-identifikohet si pjesëtar i komunitetit Roma.
- E → Subjekti vetë-identifikohet si pjesëtar i komunitetit Egjiptian.

- G → Subjekti vetë-identifikohet si pjesëtar i komunitetit Grek.
- M → Subjekti vetë-identifikohet si pjesëtar i komunitetit Maqedonas.

Vendbanimi

- T → Subjekti banon në Tiranë.
- NT → Subjekti banon jashtë Tirane.

Statusi i paaftësisë

- Y → Subjekti ka paaftësi fizike ose mendore.
- N → Subjekti nuk ka paaftësi fizike ose mendore.

| Grupmoshat | Gjinia | Niveli i edukimit | Statusi i punësimit | Etniciteti | Vendbanimi | Statusi i paaftësisë | Nr. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 14-24 | M | P | U | A | T | N | 4 |
| 14-24 | M | P | U | A | T | Y | 5 |
| 14-24 | M | P | U | R | T | N | 3 |
| 14-24 | M | P | U | R | NT | N | 2 |
| 14-24 | M | P | E | A | T | N | 1 |
| 14-24 | M | P | E | A | NT | N | 1 |
| 14-24 | M | P | U | R | T | Y | 2 |
| 14-24 | M | S | U | A | T | N | 4 |
| 14-24 | M | S | U | R | T | N | 2 |
| 14-24 | M | S | U | A | NT | N | 3 |
| 14-24 | M | S | U | A | T | Y | 2 |
| 14-24 | M | S | S | A | NT | N | 1 |
| 14-24 | F | P | S | A | T | N | 4 |
| 14-24 | F | P | S | A | T | Y | 1 |
| 14-24 | F | P | S | R | T | N | 2 |
| 14-24 | F | P | U | A | T | N | 7 |
| 14-24 | F | P | U | A | T | Y | 2 |
| 14-24 | F | P | U | R | T | N | 6 |
| 14-24 | F | P | U | A | NT | N | 5 |
| 14-24 | F | P | U | A | NT | Y | 1 |
| 14-24 | F | P | U | R | NT | N | 1 |
| 14-24 | F | S | S | A | T | N | 1 |
| 14-24 | F | S | U | A | T | N | 3 |
| 14-24 | F | S | U | A | NT | N | 3 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 14-24 | F | S | U | R | T | N | 4 |
| 14-24 | F | S | U | R | NT | N | 1 |
| 25-44 | M | P | U | A | T | N | 43 |
| 25-44 | M | P | U | A | T | Y | 6 |
| 25-44 | M | P | U | A | NT | N | 9 |
| 25-44 | M | P | U | R | T | N | 13 |
| 25-44 | M | P | U | R | T | Y | 3 |
| 25-44 | M | P | U | R | NT | N | 3 |
| 25-44 | M | P | E | A | T | N | 13 |
| 25-44 | M | P | E | A | NT | N | 2 |
| 25-44 | M | P | E | R | T | N | 5 |
| 25-44 | M | P | E | R | NT | N | 1 |
| 25-44 | M | P | E | G | T | N | 1 |
| 25-44 | M | S | U | A | T | N | 19 |
| 25-44 | M | S | U | A | T | Y | 4 |
| 25-44 | M | S | U | A | NT | N | 7 |
| 25-44 | M | S | U | R | T | N | 6 |
| 25-44 | M | S | U | R | NT | N | 2 |
| 25-44 | M | S | E | A | T | N | 13 |
| 25-44 | M | S | E | A | NT | N | 4 |
| 25-44 | M | S | E | R | T | N | 6 |
| 25-44 | M | U | E | A | T | N | 2 |
| 25-44 | F | P | U | A | T | N | 37 |
| 25-44 | F | P | U | A | T | Y | 5 |
| 25-44 | F | P | U | A | NT | N | 4 |
| 25-44 | F | P | U | A | NT | Y | 2 |
| 25-44 | F | P | U | R | T | N | 17 |
| 25-44 | F | P | U | R | T | Y | 2 |
| 25-44 | F | P | U | R | NT | N | 6 |
| 25-44 | F | P | U | R | NT | Y | 1 |
| 25-44 | F | P | E | A | T | N | 20 |
| 25-44 | F | P | E | A | NT | N | 3 |
| 25-44 | F | P | E | R | T | N | 4 |
| 25-44 | F | S | U | A | T | N | 24 |
| 25-44 | F | S | U | A | T | Y | 2 |
| 25-44 | F | S | U | A | NT | N | 5 |
| 25-44 | F | S | U | R | T | N | 8 |
| 25-44 | F | S | U | R | T | Y | 1 |
| 25-44 | F | S | U | R | NT | N | 3 |
| 25-44 | F | S | E | A | T | N | 26 |
| 25-44 | F | S | E | A | T | Y | 4 |
| 25-44 | F | S | E | A | NT | N | 7 |
| 25-44 | F | S | E | A | NT | Y | 1 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 25-44 | F | S | E | R | T | N | 11 |
| 25-44 | F | S | E | R | T | Y | 3 |
| 25-44 | F | S | E | R | NT | N | 5 |
| 25-44 | F | U | E | G | T | N | 2 |
| 25-44 | F | U | E | G | NT | N | 2 |
